



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në Gjuhë  
Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi  
dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë**

**“Universiteti i Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Asoc.Dr. Dhurata Hoxha

2. Dr. Drita Brahimi

Mars 2023


**Për Programin e studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretimi**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gjuhës Frënge (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM nr.174, datë 29.09.1998 (IAL deklaron qe ky program studimi eshte hapur me VKM Nr. 174, datë 29.09.1998. ASCAL nuk e disponon kete dokument.) Por ekziston VKM nr.359, dt.21.09.1991 "Për riorganizimin e disa fakulteteve". Vendoset hapja e degës së gjuhës franceze.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr. 297, dt. 20.07.2012
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike/ 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuhë frënge
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	20 PAE/1 PAK
18	Numri i studentëve:	135 studentë të rregjistruar për 1 cikël të plotë studimi.
19	Komente / të tjera:	-

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)




## **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

### **Përshkrim përmbledhës**


Si një program i licensuar sipas VKM Nr.174, datë 29.09.1998, programi i studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim, i përditësuar sipas VKM- së Nr. 41, datë 24.01.2018, ofrohet nga Departamenti i Gjuhës Frënge, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, në koordinim të veprimtarive formuese, edhe me njësitë e tjera kryesore të Universitetit të Tiranës. Është i organizuar në bazë të marrëveshjes së Kartës së Bolonjës (shkresa Nr. 4521, Datë 25.06.2007 të MASH dhe legjislacionit në fuqi).

Programi Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim është i ndarë në tri profile: “Gjuhë, kulturë dhe qytetërim frëng”, “Përkthim- interpretim” ose “Komunikim ndërkulturor dhe turistik” me të drejtë zgjedhjeje në vitin e tretë, duke siguruar përgatitjen e studentëve me njohuri sipas profileve, aftësi për të marrë përsipër përgjegjësi profesionale e etike, aftësi për të komunikuar në terma profesionale si dhe aftësi metodologjike bashkëkohore.

Ky program studimi bazohet në traditën dhe përvojën e shkëlqyer të DFGJ-së, i krijuar që në 1965, me pedagogë të formuar në Universitetet prestigjioze franceze dhe lektorë francezë, nga i cili janë formuar mësues të talentuar të gjuhës frënge, përkthyes/interpretë, gazetarë, gjuhëtarë si edhe kuadro të shquar në jetën shoqërore e politike të shoqërisë shqiptare dhe jashtë vendit.

Rritja e cilësisë së procesit mësimor dhe punës kërkimore-shkencore mbetet prioritet, ilustruar nga përfshirja dhe bashkëpunimi i personelit akademik në rrjete, organizata, programe dhe projekte ndërkombëtare në zbatim të strategjisë ndërkombëtarizimit të institucionit.

Objektivat e formimit mundësojnë vazhdimësinë e studimeve në ciklet Master e Doktoratë, por edhe një integrim në tregun e punës vendas e të huaj ku gjuha frënge gjen përdorim, duke iu përshtatur zhvillimeve bashkëkohore me qëllim përmirësimin dhe pasurimin ofertës së formimeve univesrisitare në gjuhë frënge. Këto objektiva përmbushen në sajë të një infrastrukture fizike bashkëkohore, duke krijuar një klimë të favorshme mësimdhënieje dhe me një komunikim dhe shkëmbim të frytshëm me studentët.



## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 për arsimin e lartë, në VKM nr. 109 për organizmin e ASCAL, dhe në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ASCAL ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga instucioni për akreditimin e programit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof.Asoc.Dr. Dhurata Hoxha dhe Dr. Drita Brahimi. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua nga koordinatori teknik i ASCAL, Msc. Arjana Alija.

GVJ u njoh dhe studioi dosjen e vetëvlerësimit duke u ndalur posaçërisht tek Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB).

Njohja dhe studimi i dosjes çoi në shqyrtimin e RVB-së dorëzuar nga DFGJ dhe në formulimin e pyetjeve që lidhen me nevojën për qartësimin e gjetjeve në RVB, saktësimin e vlerësimeve, plotësimin e informacioneve dhe konkretizimin e paraqitjeve. Për të realizuar këta objektiva, GVJ u njoh fillimisht me axhendën e vizitës në institucion. Vizita u realizua më 28 dhe 29 shtator 2022. Gjatë vizitës, ne zhvilluam takime me Dekanen e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Shefen e Departamentit të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim, grupin e vetëvlerësimit, stafin akademik, studentët, njësinë bazë të sigurimit të cilësisë, përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, Zyrës së Karrierës, Sekretarisë mësimore, Drejtorisë së Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Mrrëveshjeve me Jashtë, etj.

GVJ vizitoi gjithashtu mjediset mësimore dhe laboratorike ku zhvillohet programi i studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim. Në këto takime GVJ u njoh më nga afër me nivelin e plotësimit të standarteve të kërkuara në ofertën e programit, organizimin, drejtimin dhe administrimin e tij, mësimdhënien, mësimnxënien dhe ushtrimin e kompetencave, burimet financiare, infrastrukturën, logjistikën për realizimin e këtij program studimi, trajtimin e studentëve dhe gjithë mbështetjen për to si dhe punën që bëhej për sigurimin e cilësisë.


Mbështetur në dokumentacionin bazë të sistemuar në dosjen e vetëvlerësimit, informacionet e marra, plotësimet, saktësimet si dhe gjetjet konkrete, GVJ organizoi dhe sistemoi të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe të domosdoshëm për hartimin e raportit të vlerësimit të jashtëm (RVJ).

*Më datë 09.02.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 1/23 Prot., datë 09.02.2023, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet përmes sistemit AMS, datë 22.02.2023 dhe me shkresë zyrtare Nr. 68/6 Prot., datë 23.02.2023 nga ASCAL, ku*

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)





shprehu dakordësinë e saj lidhur me përmbajtjen e DRVJ-së. Në këtë mënyrë Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim**


**I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim është hartuar dhe ofrohet në përputhje me misionin e arsimit të lartë (Ligji i Arsimit të Lartë 20/2015, neni 1: <a href="https://www.unitir.edu.al/images/dokumenta/Legjislacion/Ligj_80-2015_22.07.2015.pdf">https://www.unitir.edu.al/images/dokumenta/Legjislacion/Ligj_80-2015_22.07.2015.pdf</a> ), rolin dhe misionin e Universitetit të Tiranës, planin Strategjik të Universitetit të Tiranës të vitit 2018-2023, Rregulloren e programit të studimit si dhe të misionit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja. Pra, rezulton që ky program studimi është në përputhje me interesat kombëtare dhe nuk bie ndesh me to.
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Si pjesë e UT-së dhe FGJH-së, programi i studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim kontribuon në përmbushjen e synimeve të Universitetit të Tiranës për të përgatitur specialistë në një formim gjuhësor dhe shkencor me drejtim shkenca humane për një përdorimin sa më efikas të gjuhës frënge. Duke qenë se në ciklin e dytë ofrohen programe studimi për përgatitjen e mësuesve, përkthyesve, specialistëve të komunikimit, rezulton se programi i studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim e plotëson profilin kulturor kombëtar.
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim rezulton të jetë në përputhje me misionin e UT-së dhe të FGJH-së pasi synon pajisjen e studentëve me njohuri të gjuhës së shkruar, të gjuhës së folur, por edhe të kulturës, të historisë dhe të letërsisë frënge si edhe edukimin e tyre me qasje, bindje dhe vetëdije ndërkulturore dhe aftësi komunikative e njohuri të integruara për të përballuar kërkesat e sotme dhe të nesërme në profesione të ndryshme ( E: 2.1.1)
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	I hartuar nga DGJF, rezulton se programi i studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim përmban një kurrikulë të pasur e cila është në përputhje me zhvillimin ekonomik lokal e kombëtar, me anë të së cilës synohet formimi i studentëve me njohuri të integruara, qasje dhe ide për të ndikuar në zhvillimin lokal dhe kombëtar në sektorin shtetëror dhe atë publik. (E: 1.12)
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>X</b>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)






<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës (E: 1.2) u evidentua se programi i studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim është në përputhje me Planin Strategjik të UT-së 2018-2024. vizionin dhe misionin e UT-së, i cili synon të formojë studentë të aftë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese, të thelluar dhe shkencore për gjuhën, kulturën, letërsinë, shoqërinë dhe teknologjinë dhe që janë të aftë të shpalosin ide të reja për të përballuar sfidat e mëdha të kohës.

<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Nga vizita në institucion si dhe nga verifikimi i dokumentacionit përkatës rezulton se drejtimet prioritare të zhvillimit akademik të institucionit janë përcaktuar në Strategjinë e Institucionit, Statutin e Universitetit si dhe në rregulloren e Fakultetit të Departamentit të Gjuhës frënge. Sigurisht, programi i studimit “Bachelor në Gjuhë frënge është në përputhje me këto drejtime, përkatësisht, formim akademik dhe shkencor, edukim dhe shërbim ndaj publikut me qëllim integrimin profesional të studentëve në përputhje me nevojat sociale, ekonomike dhe kulturore. (E: 2.1.1).						
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	Programi i studimit “Bachelor në Gjuhë frënge” ofrohet nga Departamenti i Gjuhës frënge. Kjo është në përputhje me fushat studimore që ky departament mbulon pasi ai ofrohet në gjuhë të huaj (frënge) lidhet me fusha, të tilla si komunikimi, mësimdhënia, përkthimi, studime gjuhësore, letrare e kulturore, që synojnë formimin e specialistëve të gjuhës, të aftë për të shërbyer në sektorin publik e privat dhe për të vazhduar studime më të thelluara në fushat e komunikimit, përkthimit e mësimdhënies etj. (E:2.1.1).						
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	Vlerësohet fakti se në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim përcaktohen qartë objektivat formues dhe karakteristikat e programit të studimit si edhe në mënyrë të detajuar njohuritë dhe kompetencat e studentëve në përfundim të programit mësimor. Kurrikula është e hartuar në atë mënyrë sa të realizohet një aftësim vetjak dhe organizim i pavarur, aftësim shoqëror dhe komunikues i studentëve të cilët pajisen me njohuri bazë të gjuhës frënge, njohuri rreth letërsisë, kulturës dhe historisë së vendeve frankofone, njohuri rreth çështjeve si komunikim ndërkulturor, kompetencë ndërkulturore, takime kulturore, mësimdhënie, përkthim dhe interpretim sipas profileve të studimit (E: 2.1.1).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë	Bazuar në evidencat 1.13, 1.14, ku pasqyrohet analiza e tregut të punës në rang universiteti dhe në rang fakulteti, u evidentua se edhe për programin e studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim studimi është kryer në disa faza në të cilat evidentohen të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës. Edhe në takimin me anëtarët e zyrës së këshillimit të karrierës GVJ u informua se ajo kryen periodikisht mbledhje dhe analiza të dhënash në lidhje me

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)




<p>e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>studentët që ndjekin këtë program studimi si edhe gjurmon ecurinë e tyre mbi mundësitë e tyre të punësimit, sipas tri profileve: mësuesi, përkthim dhe turizëm. Përsa u përket zhvillimeve të pritshme në sektorin përkatës, në evidencat 5.20 dhe 5.21 evidentohen dy ngjarje të rëndësishme të organizuara nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja dhe Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë Panairi i punës 2022 me 30 kompani si edhe Edicioni parë Syn+ergasia jobs and skill fairs, me anë të të cilave u synua vënia në kontakt e studentëve me punëdhënësit potencialë, por edhe përshtatjen e kurrikulave dhe programeve në përputhje me tregun e punës. Pra, vihet re që i kushtohet vëmendje e veçantë lidhjes së studentëve me mjedisin profesional dhe me kërkesat e tregut të punës me qëllim që të krijohen kushte të volitshme për një të ardhme të sigurt të tyre.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Për nga përmbajtja, programi i studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim është hartuar dhe strukturuar në mënyrë të tillë që të u përgjigjet kompetencave dhe dijeve bazë dhe të fushës në mënyrë që të aftësojnë studentin për tregun e punës. Bazuar në planin strategjik të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja ku në fokus janë përmirësimi dhe rivlerësimi i vazhdueshëm i programeve të studimit me qëllim arritjen e rezultateve të cilat garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave aktuale të tregut, vihet re se pas analizës së kryer nga grupet mësimore ndërdisiplinore dhe diskutimeve të mëtejshme, janë realizuar ndryshime cilësore në programin e studimit pas miratimit nga komisioni i programeve e më pas nga DFGJ dhe Senati Akademik. Kjo gjë u konfirmua edhe nga Zyra e kurrikulave dhe cilësisë gjatë vizitës në fakultet. Aty GJVJ u informua se ishte marrë parasysh edhe propozimi i studentëve për shtimin e numrit të seminareve.</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p style="text-align: right;">X</p>

<p><b>Standardi 1.4</b></p>	
<p><b>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Lidhur me plotësimin e këtij kriteri, RVJ iu referua gjetjeve në RVB si dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion. Nisur nga këto, mësohet që institucioni i ka burimet, kapacitetet dhe përvojën e duhur për të ofruar programin e studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim. Në RVB burimet, përvoja dhe kapacitetet e Universitetit të Tiranës paraqiten në mënyrë të detajuar duke vënë në pah faktin se Universiteti i Tiranës, falë traditës, nivelit të lartë të përgatitjes mësimore dhe shkencore, mbetet universiteti më i kërkuar në Republikën e Shqipërisë dhe në troje. Dhe Fakulteti i Gjuhëve të huaja, pjesë e të cilit është edhe Departamenti i Gjuhës frënge disponon përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike në këtë program studimi falë Stafit akademik dhe atij ndihmës). Të formuar dhe të kualifikuar ndër vite në universitetet prestigjioze franceze pedagogët e këtij departamenti kanë përcjellë dhe përcjellin tek studentët njohuri dhe metodologji bashkëkohore. Nuk mund të anashkalohet as angazhimi i lektorit/es francez/e si një folës për të cilin gjuha frënge është gjuhë amtare. Nga ky departament janë formuar mësues të talentuar të gjuhës frënge, përkthyes/interpretë, gazetarë, gjuhëtarë si edhe kuadro të shquar në jetën shoqërore e politike të shoqërisë shqiptare. Gjatë vizitës në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, përveç sa u përmend më sipër, rezultojnë të jenë efikase burimet infrastrukturore të cilat janë ndër elementet bazë për një mbarëvajtje të punës në këtë institucion. Mund të përmendim bibliotekën</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)





	dhe pajisjen e sallave me mjetet didaktike të teknologjisë së fundit të cilat dëshmojnë për kapacitet e duhura në këtë program studimi. Prandaj, mund të konkludohet se ekzistojnë përvoja, kapacitetet dhe burimet e duhura për ofrimin e këtij programi studimi.
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	U evidentua se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të FGJH-së sipas Klasifikimit Standard Ndërkombëtar për Arsimin (2013). Programi i studimit “Bachelor në gjuhën frënge” përputhet me fushën e gjerë (broad field), kodin 02 për “Artet dhe Shkencat Humane”, fushën e ngushtë (narroë field), kodin 020 për “Shkencat Humane pa përcaktime të mëtejshme”, gjë që shprehet qartë në objektivat formues të programit: “formim gjuhësor dhe shkencor me drejtim human mbështetur në faqen e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Për të mos e rrimarrë atë çka GVJ evidentoi më sipër, klasifikimi sipas kodeve të fushës përkatëse, siç theksohet në RVB, ka lehtësuar njohjen e programit dhe ka forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe mobilitetin e studentëve dhe stafit. Në kodin 02 të fushës së gjerë ( <i>broad field</i> ). “Arte dhe shkencat Humane”, programi përkon me fushën e ngushtë ( <i>narrow field</i> ). “Gjuhët” me kodin 023, i klasifikuar në mënyrë më të specifikuar në këto fusha: 0230 “Gjuhët pa përcaktime të mëtejshme”, 0231 “Përvetësimi i gjuhës”, 0232 “Letërsi dhe gjuhësi”, 0239 “Gjuhët pa klasifikime gjetkë”, gjë që shprehet qartë në objektivat formues të programit, disiplinat dhe veprimtaritë formuese të tij.
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	
	X

<b>Standardi 1.5</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Për përmbushjen e këtij kriteri përpos RVB-së, GVJ mori informacione plotësuese gjatë vizitës në institucion. Aty mësoi se se DGJF ka marrëdhënie të mbështetura në akte ligjore e nënligjore me të gjitha njësitë kryesore e ato bazë brenda institucionit, duke siguruar në këtë mënyrë një bashkëpunim funksionues jo vetëm me departamentet e FGJH-së, por edhe me fakultete të tjera të UT-së, si Fakulteti Histori-Filologji dhe Fakulteti i Shkencave Sociale. U evidentua se për këtë bashkëpunim zhvillohet analiza e vazhdueshme e kësaj pune e cila pasqyrohet në raportet vjetore të punës së departamentit si dhe në raportet e sigurimit të cilësisë ( E: 1.11, 1.12).
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.	Përveç gjetjeve në RVB lidhur me bashkëpunimin e institucionit, ku bën pjesë edhe DGJF, me institucione homologe brenda e jashtë vendit si dhe aktorët e biznesit vendas e të huaj në realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, GVJ u informua edhe gjatë takimit me përfaqësuesit e Drejtorisë së Kërkimit shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me jashtë, se kjo Drejtori ka funksion koordinues për projektet (6 projekte nga Departamenti i gjuhës frënge) me fokus përfshirjen e njësisë dhe programeve të tjera të studimit. Në lidhje me mobilitetet në kuadër të Erasmus, u theksua se edhe gjatë periudhës së pandemisë nuk janë ndërprerë mobilitetet. Këto bashkëpunime janë konkretizuar me bashkëpunime të tilla si: rasti i bashkëpunimit me Universitetin e Torinos,

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)




	<p>Universitetin e Sofies, Universitetin e Puatiesë, universitetin e Zagrebit, universitetin e Lozanës etj. Përveç studentëve shqiptarë, në kuadër të programit Erasmus, 4 studentë nga Universiteti i Torinos janë pritur nga departamentet e gjuhës frënge, italiane dhe angleze. RVJ mësoi gjithashtu se Departamenti i Gjuhës Frënge merr pjesë çdo vit në thirrjet për projekt që hap AUF-ja duke lidhur marrëveshje bashkëpunimi në fusha të ndryshme si formimet universitare, kërkimi shkencor, integrimi i studentëve në tregun e punës etj. Përsa i përket bashkëpunimit me aktorët e biznesit apo palët e treta, mësohet se në vitin 2019 është realizuar projekti me temë “Audioguidat për Muzeun me Gjethe” në bashkëpunim me Muzeun me Gjethe dhe Radio Tiranën. Këto autoguida janë realizuar nga studentët e Departamentit të Gjuhës Frënge.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit, harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Përpos evidencave të paraqitura në RVB, gjatë vizitës në institucion GVJ mësoi se raportet analitike mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit janë pjesë e integruar e analizës vjetore të FGJH-së dhe diskutimeve në mbledhjet e departamentit dhe konsistojnë në vlerësimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe aktiviteteve të mundësuar në kuadër të tyre (sidomos të konferencave shkencore dhe botimeve) dhe të shkëmbimeve për mobilitete të stafit dhe pedagogëve, në komunikimin e eksperiencës së fituar tek anëtarët e tjerë të personelit akademik dhe nxitjen e mëtejshme të mobiliteteve të stafit dhe studimit përmes rekomandimeve dhe detyrave për të ardhmen. Gjatë vizitës në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja GVJ u informua se pjesëmarrja e stafit akademik bëhet me vullnetarizëm dhe në varësi të fushës së përzgjedhur. GVJ mësoi gjithashtu se këto projekte kanë mundësuar përmirësimin e infrastrukturës së fakultetit duke siguruar pajisjen e sallave me mjete didaktike bashkëkohore si edhe laboratorë për mësimdhënien e përkthimit, etj.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Përsa i përket praktikës, programi i studimit “Bachelor në gjuhën frënge” në kurrikulën e tij nuk ka komponentë praktikë.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkëpunim me punëdhënësit.</p>	<p>GVJ u informua se në Universitetin e Tiranës është ngritur Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, e cila në mënyrë të vazhdueshme organizon trajnime, seminare, leksione të hapura dhe ëorkshop-e në tematika të ndryshme. Qendra e trajnimeve siguron ekspertizë dhe këshillim profesional bazuar në rezultatet e punës kërkimore-shkencore (Faqja zyrtare e USH-së. Këto trajnime ofrohen nga UT pa tarifë për stafin akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe studentët (E: 5.21).</p>
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p style="text-align: right;">X</p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b></p>	<p style="text-align: right;">X</p>
--	-------------------------------------


## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

**Standardi II.1**  
**Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)





Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim është hartuar në përputhje me legjislacionin vendas siç janë: Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” (E: 2.1, E:1.22), si të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Trasferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS) (E: 2.14). Vihet re një ndarje e balancuar e lëndëve në lëndë të formimit bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, plotësuese dhe detyrime përmblyëse sipas udhëzimeve të MAS, me 180 kredite europiane (ECTS) dhe për 3 vite akademike të ndara në gjashtë semestra me peshën e fitimit të 30 krediteve për semestër. Nga konsultimi i dosjes dhe elementeve të saj rezultoi se është ruajtur raporti teori-praktikë dhe punë mësimore në auditor-punë individuale e studentit me synimin e përmbushjes së rezultateve të pritshme.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Përmes moduleve dhe lëndëve që ofron, ky program studimi synon të formojë specialistë të gjuhës frënge në fushën e përkthimit dhe komunikimit me një gamë të gjerë njohurish mbi gjuhën, kulturën, qytetërimin, letërsinë frënge, didaktikën, përkthimin dhe interpretimin për të përgatitur mësuesit, përkthyesit/interpretët, kritikët letrarë dhe udhërrëfyes turistikë me shprehje profesionale për të punuar në këto sektorë, duke krijuar terrenin e volitshëm për studime të mëtejshme në ciklin e dytë të studimeve universitare, por jo vetëm.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparura në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorieve dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Duke qenë se përmbajtja e programeve lëndore dhe literatura e përdorur janë dy elemente të rëndësishme në drejtim të njohurive të përparuara për këtë fushë studimi dhe më tej në drejtim të zhvillimit të kompetencave shkencore dhe profesionale të studentëve si edhe referuar emërimit të programeve lëndore dhe takimeve me studentët, RVJ vlerësoi se përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim krijon kushte për zhvillim kompetencash profesionale dhe kërkim shkencor.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Nga konsultimi i programeve lëndore dhe takimet me studentët, RVJ mësoi se programi i studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim është në përputhje me pritshmëritë e studentëve për të zhvilluar kompetencat e tyre si kërkues shkencorë dhe si edhe ato profesionale në drejtim të njohurive me të cilat pajisen studentët sipas profileve përkatëse që ata kanë përzgjedhur gjatë tri viteve të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Pas konsultimit të dokumentacionit përkatës mbi syllabuset e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim si edhe diskutimeve me studentët RVJ vlerësoi se ato janë hartuar konform modelit të përcaktuar nga MAS. (E: 5.34) dhe janë të organizuara sipas strukturës së mëposhtme: përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënit, konceptet themelore dhe temat e lëndës apo modulit, etj (E: 3.10).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Pas konsultimit të evidencave përkatëse u evidentua se është punuar për formalizimin e planeve mësimore në lidhje me pasqyrimin e veprimtaritë formuese të ndara sipas komponentëve në kategori dhe me përqindjet e duhura për të tri profilet e këtij programi studimi. (E: 2.18, tabela 9).</p>
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p style="text-align: right;">X</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)





Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Nga takimi me përgjegjësen e Departamentit dhe anëtarë të stafit akademik të departamentit RVJ mësoi se njësia bazë ka ngritur grupin e vlerësimit të brendshëm për këtë program studimi sipas detyrimeve ligjore për funksionimin normal të tij, si dhe në përputhje me statutin dhe rregulloren e UT-së (E: 5.38) RVJ vlerësoi se kjo njësi përmbush kushtet për vijimin e procesit të vlerësimit dhe akreditimit për këtë program studimi, duke iu referuar ndjekjes së procedurës pranë ASCAL sipas ligjeve në fuqi (Neni 22, pika 3 në ligji nr. 80/2015).
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	Në zbatim të VKM 531, datë 11.09.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë të Arsimit të Lartë" u evidentua se janë caktuar kordinatorët për secilin profil të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim, pjesë e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe e UT-së (E: 2,12), të cilët informojnë vazhdimisht përgjegjësen e departamentit të Gjuhës Frënge mbi ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit në të gjitha aspektet ( E: 6.2) si dhe bashkëpunojnë me departamentin për përmbushjen me sukses të detyrimeve ligjore për vlerësimin e jashtëm të këtij programi studimi nëpërmjet procesit të akreditimit.
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Sipas evidencës 2.3, rezultojnë se ngarkesa e mbuluar përmes personelit akademik efektiv kalon masën mbi 70% referuar minimumit të kërkuar nga standardi i cilësisë, njësia kryesore bazë përgjegjëse për këtë program studimi përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Për më tepër, përse i përket raportit PAE dhe PAK në të tri profilet që përmban programi i studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim predominon PAE. Prandaj, kjo evidencë na lejon të gjykojmë se ky kriter i përmbushur plotësisht rezultojnë të jetë edhe një nga pikat e forta të këtij programi studimi.
<b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.	Referuar CV-ve të personelit akademik PAE dhe PAK dhe evidencës 2.3, vlerësojmë se ky kriter përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik si dhe nevojat e programit për kapacitete dhe burime konform fushës akademike specifike. Bazuar në të dhënat e shqyrtuara, rezultojnë se Departamenti i gjuhës frënge për vitin akademik 2020-2021 ka në përbërjen e tij një staf akademik të kualifikuar (PAE) dhe (PAK) : Prof. Dr, Prof.as.dr, Dr dhe Msc dhe rezultojnë se mbi 70% e stafit akademik ka tituj dhe grada, konkretisht: 6 Prof.Dr, 6 Prof.As.Dr, 6 doktorë shkencash, 1 doktorant, 1 personel ndihmës akademik dhe një sekretare mësimore.
<b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Sipas evidencës 2.3, rezultojnë se ngarkesa e mbuluar nga Personeli akademik Efektiv kalon masën mbi 70% referuar minimumit të kërkuar nga standardi i cilësisë, njësia kryesore bazë përgjegjëse për këtë program studimi përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Për më tepër, përse u përket raportit PAE dhe PAK në të tri profilet që përmban programi i studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim predominon PAE 20 PAE dhe 10 PAK.
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	X

**Standardi II.3**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)





Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Pas një konsultimi dhe shqyrtimi të detajuar të dokumentacionit dhe informacioneve që disponon Departamenti i Gjuhës frënge përgjegjës për programin e studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim si edhe nga takimet me dekanen e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe përgjegjësen e departamentit si edhe zyrën përkatëse të burimeve njerezore, rezultojnë se informacionet e dhëna në lidhje me programin e studimit, planin mësimor me të gjitha elementet përbërëse, rregulloren e hartuar në mënyrë të detajuar, kontrollin e dijeve, rregullat e diplomimit, të etikës akademike, etj si edhe karakteristikat e këtij programi studimi për një zhvillim të kompetencave të studenteve në funksion të mundësive të punësimit përmbushin detyrimet ligjore për vlerësim dhe akreditim. GVJ vlerësoi edhe faktin se informacioni për këtë program studimi është i aksesueshëm edhe në faqen eeb të Departamentit të gjuhës frënge. (E: 2.19 dhe E: 2.1.6)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Pas konsultimit të dokumentacionit RVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim është strukturuar në përputhje me rregulloren e programit dhe përcaktimeve ligjore në fuqi duke respektuar ndarjen e veprimtarive formuese sipas tipit të komponentëve mësimorë në kategoritë e lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/ integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse, konform rregullave që monitorojnë aspektin ligjor. Përsa u përket veprimtarive formuese të ndara sipas komponentëve mësimorë, vihet re se janë respektuar elementët e veprimtarisë formuese në emërtim dhe në ndarjen me kredite. Është bërë një ndarje e tipit të komponentëve mësimorë në kategoritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kategoria A e lëndëve Bazë që përmbajnë 17.7 % (32 ECTS);</li> <li>- Kategoria B- tipi i lëndëve Karakterizuese 52.7 % (95 ECTS);</li> <li>- Kategoria C- tipi i lëndëve Ndërdisiplinore / Integruese 14.4% (26 ECTS);</li> <li>- Kategoria D- tipi i Lëndë Plotësuese 11.1 % (20 ECTS);</li> <li>- Kategoria E- tipi i lëndëve Detyrime Përmbyllëse 3.8 % (6 ECTS).</li> <li>- (E: 2.18)</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Përmbajtja e planit mësimor për këtë program studimi rezultojnë të jetë përpiluar në përputhje me Vendimin Nr 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” në drejtim të krediteve sipas ECTS-së (E: 2.14). Është respektuar gjithashtu dhe standardi për shpërndarjen e krediteve në çdo semestër përgjatë 1 viti akademik si dhe për shpërndarjen e krediteve në kurrikulën e programit të studimit duke respektuar numrin e krediteve në lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse. Programi Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim realizohet në tri vite akademike, 60 kredite për vit akademik, gjithsej 180 kredite të cilat studenti i fiton me përfundimin e studimeve (E: 2.19).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Referuar përmbajtjes së planit mësimor u evdientua se programi i studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim respekton të gjitha kriteret për sa u përket elementëve që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ndara sipas kategorive të përcaktuara me ligj, GVJ konstatoi se ky program studimi ka një informacion të detajuar konform legjislacionit në fuqi dhe një shpërndarje të qartë të planit mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, kreditet dhe ndarjen sipas semestrave akademike. Për më tepër, edhe në rregulloren e këtij programi studimi specifikohen rregullat</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.asc.al](http://www.asc.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)







	e frekuentimit të procesit mësimor dhe mënyrat e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve të cilat kombinojnë vlerësimin e vazhduar me atë përfundimtar. (E: 2.1.1)
<b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Në rregulloren e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim (E: 1.10, Neni 7,4.b) dhe ( E: 2.1.1) specifikohen qartë kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit në këtë program studimi si dhe procedurat e ndjekura në pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e programit të studimit bazuar në rregulloren e regjistrimeve dhe transferimeve të UT-së, bazuar në kapacitetet pritëse dhe akademike sipas përcaktimeve të VKM-SË Nr.418, datë 10.05.2017. U evidentua gjithashtu se janë ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme dhe të gjitha janë të evidentuara jo vetëm me evidencë, por edhe me publikime në faqet eeb dhe në fletëpalosjen dhe guidën studentore e cila përditësohet çdo vit ( E: 5.9).
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Pas konsultimit të vëmendshëm të informacioneve të ofruara në këtë RVB, GVJ konstatoi se syllabuset e detajuara për secilën lëndë janë hartuar nga titullari i lëndës duke ndjekur modelin standard në shtojcën nr. 2 në VKM nr. 41, datë 24.01.2018. (E:1.22) (E: 2.1) ku përfshihen informacione të detajuara për lëndën, emërtimin/kodin e saj, titullarin/pedagogun e lëndës, ngarkesën (numri i krediteve, numri i orëve mesimore në klase, leksion dhe seminar, praktika etj.), përgjithësisht tipologjinë e lëndës, vitin akademik/semestrin kur zhvillohet, llojin e lëndës (e detyrueshme ose me zgjedhje), programin e studimit ku ofrohet, adresën elektronike të titullarit/e pedagogut të lëndës, temat që përfshihen, mënyren e kontrollit të dijes (frekuentimin dhe format e kontrollit të vazhdueshëm të dijeve), literaturë bazë, e detyrueshme dhe e rekomanduar dhe sipas një ndarjeje të lëndëve mësimore në semestra duke respektuar peshën e ngarkesës në semestra dhe duke ruajtur numrin e krediteve për çdo semestër akademik.
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohen dosja e plotë.	Duke iu referuar të dhënave që u shqyrtuan nga GVJ, është punuar në mënyrë të vazhdueshme për perfeksionimin dhe përditësimin e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim, kryesisht në programe lëndore, me përmirësimin e përmbajtjes, literaturës, pavarësisht se jo të gjithë, metodologjisë etj. [E: 2.24) (Tabela 11).) Vihet re se janë ndjekur të gjitha procedurat e duhura për realizimin e ndryshimeve: përmes analizës vjetore të DGJF-së, të FGJH –së me rekomandimet dhe sugjerimet, ngritjen e grupeve të punës, diskutimet në Komisionin e Programeve, diskutimin dhe miratimin në departament. GVJ vlerëson gjithashtu faktin se procedurat janë kryer duke ndjekur një shkallë hierarkie : Senat Akademik (sipas nenit 38, pika 1/dh) e më pas në Rektorat (E: 2.1.1: Neni 10. Pika 2).
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>X</b>

<b>Standardi II.4</b>	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore	Pas konsultimit të evidencave përkatëse : (E: 2.25) (E: 2.26) Tabela 13) mbi ngarkesën e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim në lidhje

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.asc.al](http://www.asc.al)

E-mail: [info@asc.al](mailto:info@asc.al)





në fuqi.	me zbatimin e Komizës Shqiptare të Kualifikimeve, shtrirjen e ngarkesës javore në auditor apo sasinë mesatare të punës së studentit në auditor e të punës së tij të pavarur individuale, format e rënësmdhënies në programin e studimit etj, rezultojn të ketë një koherencë me parashkimet e akteve ligjore në fuqi për arsimin e lartë.
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Mbështetur në VKM Nr. 41, dt.24.01.2018, programi i studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim përmban lëndë të emërtuara dhe të grupuara në koherencë me emërtimin e tij. Në këtë drejtim, GVJ vlerësoi faktin se mundësohen njohuri të përparuara gjuhësore, kulturore e letrare në gjuhë frënge, formim shkencor në fushat e gjuhësisë dhe nëndisiplinave të saj, si dhe formim profesional për mësimdhënie në të ardhmen, komunikim e përkthim si edhe në fusha specifike të programit të detajuara në syllabuset e lëndëve. (E: 2.1.6). Komponentët mësimorë u shërbejnë interaktivitetit të studentëve me pedagogun, stimulimit të mendimit krijues/novator dhe kritik, zhvillimit të aftësive komunikuese, njohurive shkencore e profesionale në funksion të tregut të punës dhe punësimit të tyre. Pavarësisht se nuk ofrohet asnjë praktikë profesionale (Tabela5) për asnjërin profil të këtij programi studimi, GVJ vlerësoi qasjet e përdorura për studimin e tregut të punës (E: 1.14)
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional.	Plani mësimor i këtij programi studimi, i cili është në përputhje me Vendimin Nr 41, datë 24.01.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, në drejtim të krediteve sipas ECTS-së, respekton standartet për shpërndarjen e krediteve në shtrirje proporcionale përgjatë 3 viteve akademike. Rezultojn se ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik krijon terrenin e volitshëm për arritjen e objektivave formuese të këtij programi studimi dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional. GVJ vlerësoi logjikën e ndjekur për shtrirjen e lëndëve sipas kategorive duke i përshtatur me shkallën e vështirësisë në mënyrë progresive dhe të natyrshme.
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Referuar të dhënave të shqyrtuara nga GVJ struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim. Plani mësimor i këtij programi studimi respekton standartet për shpërndarjen e krediteve në shtrirje proporcionale përgjatë 3 viteve akademike. Një balancë e ngjashme është respektuar edhe në shpërndarjen e krediteve në kurrikulën e programit të studimit duke respektuar numrin e krediteve në lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinare/integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse. Gjatë konsultimeve me elementet që ky program studimi ofron u evidentua se ekuivalentimi i lëndëve apo moduleve është i arritshëm dhe se ky program lehtëson mobilitetin e studentëve brenda dhe jashtë vendit.
<b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Bazuar në koherencën e elementëve të këtij programi studimi, GVJ konstatoi se peshën më të madhe e kanë lëndët karakterizuese pasi ato i përgjigjen pjesës më të madhe të kompetencave që synon programi, në formimin e specialistëve të gjuhës frënge, për fushat e ndryshme. (E: 2.1.1) Për më tepër, struktura e tij përafrohet me programe të ngjashme ndërkombëtare, ku si rezultat i kësaj janë krijuar mundësi për shkëmbimet e stafit dhe studentëve dhe sidomos për njohjen e periudhës së studimit në një universitet të huaj. (E: 2.7) (E: 2.6)
<b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	U evidentua se programi i studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim është gjithmonë në përmirësim të vazhdueshëm përmes përmirësimit të planeve mësimore çdo vit akademik dhe miratimit të tyre nga njësia bazë, me qëllim përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Nga pikëpamja e formës, GVJ konstatoi

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)








	se syllabuset hartohen bazuar në shtojcën 2 të VKM nr. 41, dt. 24.01.2018 dhe përmbajnë të gjithë elementet e parashikuar në të, referuar evidencës 3.9 dhe Tabelës 14), përfshirë literaturën e detyruar dhe ndihmëse të viteve të fundit.								
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	GVJ mësoi se programi në tërësinë e vet është hartuar që të garantojë përfundimin e kompetencave bazë, gjuhësore, të fushës/profesionale dhe të dijeve dhe aftësive korresponduese të përshtatshme për ciklin e parë të studimeve (E: 2.1.1). Çdo lëndë në program përmbush nevojat për zhvillimin e një apo më shumë kompetencave të programit nëpërmjet dijeve, rezultateve të të nxëniet dhe aftësive që synon të garantojë përmes përmbajtjes së vet.								
<b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Duke qenë se ky program studimi ofron formim të studimeve në tri profile, studentëve u krijohet mundësia që të vijojnë studimet në programe të ciklit të dytë; përkatësisht “Master i shkencave” në Mësuesi për AML për gjuhën frënge, në bashkëpunim me të gjitha departamentet e FGJH ofrojnë dy programe studimi “Master i shkencave në Komunikim ndërkulturor dhe turistik” si edhe dhe “Master i shkencave në Përkthim dhe interpretim”, duke krijuar në këtë mënyrë kushte të favorshme për një mundësi punësimi në arsim, turizëm, shtëpi bootuese, agjensi përkthimi, agjensi turistike, hotele apo edhe në administratë publike.								
<b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	GVJ vlerëson faktin se punohet denjësisht për përmirësimin e këtij programi studimi në funksion të përshtatjes sa më të mirë me kërkesat e tregut të punës. Vlerësohet kryesisht nisma e ndërmarrë nga NJSBC e cila në bashkëpunim me Drejtorinë e Edukimit, Drejtorinë e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore dhe fakultetet respektive me datë 18.12.2019, organizoi <i>ëorkshop</i> -in me temë “Studentët dhe tregu i punës”(E: 5.20).								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Bazuar në të dhënat e e ofruara gjatë takimit dhe në evidencat rezultojn se në programin e studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim angazhohet personel akademik me kohë të plotë efektiv dhe me kontratë. Personeli akademik përgjegjës për këtë program studimi përfshin personel nga kategoritë: “profesor”, “lektor” dhe “asistent-lektor” (6 Prof.Dr, 6 Prof.As.Dr, 6 doktorë shkencash, 1 doktorant dhe një personel ndihmës akademik.). Nga verifikimi i i bërë në lidhje me personelin akademik të përfshirë në mësimdhënie, konstatohet një qëndrueshmëri në stafin akademik. Më se 90% e ngarkesës mësimore në këtë program studimi realizohet nga PAE. Bazuar në evidencën 2.29, tabela 6 GVJ vlerëson faktin se 50% e stafit akademik i përket kategorisë Prof dhe Prof.As.Dr. Në mbështetje të nenit 59, pika 6 në ligjin nr. 80/2015, GVJ konstatoi se përmbushen kërkesat ligjore në këtë pikë.
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin	Nga verifikimi në institucion dhe mbështetur në evidencat e përpiluara nga GVB rezultojn se programi mësimor është realizuar nga personeli akademik me kualifikimin e nevojshëm. Në këtë program studimi angazhohet personel akademik me kohë të plotë që ka së paku kualifikim të ciklit pasardhës në fushën e programit (vetëm një doktorant) (E:2.29). Personeli akademik i programit bën pjesë në

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.asc.al](http://www.asc.al)

E-mail: [info@asc.al](mailto:info@asc.al)



në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	grupet mësimore të programit sipas profilit të kualifikimit apo interesave akademike e kërkimore, duke realizuar një mësimdhënie cilësore falë angazhimit akademik të të gjithë personelit akademik për mbulimin e moduleve/lëndëve të programit.
<b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	Bazuar në evidencën 2.1.4 GVJ konstaton se personeli akademik i këtij programi angazhohet jo vetëm në mësimdhënien e moduleve dhe lëndëve sipas kualifikimit të duhur akademik dhe shkencor, por edhe në organizim aktivitetesh kërkimore-shkencore, merr pjesë në aktivitete shkencore dhe realizon botime në përputhje me programin e studimit, merr pjesë dhe/ose harton projekte shkëmbimi për stafin dhe studentët. Nga takimi me Drejtorinë e Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marëdhënieve me jashtë vlerësojmë faktin se stafi akademik i këtij programi studimi është përfshirë në 6 projekte shkëmbimi mes pedagogësh dhe studentësh edhe me njësi e programe të tjera studimi në rang fakulteti. Kjo dëshmohet edhe në Evidencat mbi punën shkencore të realizuar dhe CV-të e pasura të personelit akademik si edhe dhe në tabelën 5 ku pasqyrohen marrëveshjet ndërinstucionale.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Bazuar në gjetjet e RVB-së, përsa i përket praktikës profesionale, në asnjërin nga profilet e këtij programi studimi nuk ofrohet një e tillë. Gjithsesi, modulet dhe lëndët janë përpiluar në atë mënyrë që të kenë vijimësi në ciklin e dytë të studimeve. Diploma Bachelor mbrohet me provim formimi ose punim (tezë) diplome. Brenda një muaji nga data e fillimit të vitit akademik, Përgjegjësi i Departamentit u bën të njohur studentëve, të cilët diplomohen atë vit, programin e provimit të formimit ose të temave të diplomave, me anën e të cilave do të bëhet vlerësimi përfundimtar Studentët që kanë mesatare mbi 8 fitojnë të drejtën e zhvillimit të një punimi diplome. Në evidencën 2.29 rezulton se studentët udhëhiqen nga pedagogët e tyre për realizimin e temës së diplomës, konkretisht 4 pedagogë.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Referuar RVB-së dhe gjetjeve nga vizita në institucion, GVJ mësoi se institucioni ka të angazhuar personel akademik ndihmës për mbarëvajtjen e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim, përveç auditorëve, përdoren edhe mjedise të tjera si Laboratorë dhe Biblioteka të Gjuhëve të Huaja, në kushte shumë të mira për studentët për t'u praktikuar apo konsultuar literaturën. Për mirëmbajtjen e këtyre mjediseve është i angazhuar personel ndihmës akademik, të tillë si laborantë, specialistë të IT dhe me formim përkatës edhe në gjuhë të huaja.
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	
	X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	
	X


### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b> Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)





<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>UT, pjesë e të cilit është edhe FGJH dhe departamenti i gjuhës frënge, njësia bazë e cila administrojnë programin e studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim, ka përgatitur një strategji të plotë dhe ambicioze për mësimdhënien në përputhje me standartet shtetërore të cilësisë duke synuar përmirësimin dhe diversifikimin e vazhdueshëm të metodave si dhe sjelljen e atyre innovative. (E: 1.2: Strategjia e Zhvillimit të UT 2018-2023, pika 1.1,1.2).</p> <p>Në kushtet e pandemise globale shkaktuar nga Covid-19, UT implementoi mesimdhënien dhe zhvillimin e provimeve on line nëpërmjet “Microsoft Teams for Education” si një metodë e re duke ofruar edhe udhëzues për përdorimin e tyre. (E: 3.2,3.3) Kjo platformë i mundësoi stafit akademik dhe studentëve të shkëmbejnë materiale dhe informacione në funksion të procesit mësimor.</p> <p>UT, nëpërmjet qendrës virtuale të trajnimit ofron herë pas herë trajnime mbi metodat innovative në mësimdhënie.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative për personelin akademik, njësia bazë ka ngritur një strukturë të quajtur Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë i cili vepron në përputhje me veprimtarinë e Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë ngritur në rang të UT-së. (E : 6.2,6.3,6.6,6.8 dhe takimi me këtë njësi gjatë vizitës në institucion))</p> <p>Përmes tyre monitorohet puna e personelit akademik dhe ndihmës akademik në drejtim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe avancimit në drejtim të kërkimit shkencor. Format që përdoren për këtë vlerësim janë të larmishme. Analiza e të dhënave të grumbulluara dhe publikimi i tyre shërben për të përmirësuar performancën e personelit akademik dhe jo akademik.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët u evidentua se ata përfshihen në vlerësimin periodik të përmbajtjes apo literaturës së lëndëve, formave të mësimdhënies nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve i cili realizohet në fund të çdo semestri. Studenti ka mundësi të shprehet në mënyrë anonime për pedagogët e angazhuar në mësimdhënie, por edhe për stafin ndihmës në mbështetje të mësimdhënies.</p> <p>FGJH si strukturë e UT-së përdor procedura transparente dhe brenda një kohe të shkurtër për trajtimin e ankimeve të studentëve për vlerësimin e dijeve</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Nga konsultimi i dokumentacionit vërehet se strukturat përgjegjëse për monitorimin e sigurimin e cilësisë dhe respektimin e standarteve të reja për rritjen e cilësisë në mësimdhënie, kanë ndërmarrë disa nisma që synojnë të ndihmojnë institucionin në këtë drejtim. NjSBC (E/4,6.17) ka hartuar një plan i cili lejon të mblidhet një informacion i detajuar mbi një sër aspekteve si vështrimi i përgjithshëm i gjendjes së programit të studimit, plani i veprimit për vitin e ardhshëm, raportimi mbi veprimtaritë e ndërmarrë, feedback-u i marrë nga studentët dhe stafi akademik në nivel programi, statistika të regjistrimit të studentëve dhe të kalueshmërisë së tyre, burimet mbështetëse të programit të studimit, vlerësimi i jashtëm, karriera dhe alumnit. Ky vlerësim kryhet nga grupi i sigurimit të cilësisë bazuar në rregulloren e tij dhe monitoron programin në vijimësi, duhe u siguruar informacione të rëndësishme si zyrës së sigurimit të cilësisë në nivel institucional ashtu edhe njësisë kryesore dhe asaj bazë. Po kështu, përmes takimeve të përbashkëta me pjesëmarrjen e njësisë, stafit akademik dhe studentëve në lidhje me cilësinë e ofruar të shërbimeve. Prania e këtyre elementëve konsiderohen me ndikim pozitiv Vlerësimet periodike të ndërmarrë nga institucioni pas zbardhjes së rezultateve i vihen në dispozicion njësisë bazë dhe asaj kryesore.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)





<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	UT dhe Departamenti Gjuhë frënge ka mekanizma të vlerësimit të performancës së stafit akademik dhe jo akademik (E:6.4, E:1.10 neni 10). GVJ i konsideron si aspekte pozitive në drejtim të stimulimit dhe nxitjes së personelit akademik në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në mësimdhënie dhe për avancim në karrierën e tyre profesionale.
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>X</b>

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Nga konsultimi i programeve lëndorë dhe takimet me studentët, mësohet se sistemi i transmetimit të dijeve bazohet kryesisht në leksionet interaktive, seminarët në funksion të një të kuptuari më të mirë të tematikave që diskutohen në leksione, detyrat e kursit, projektet. Vlerësojmë veprimtaritë e tjera si leksionet e hapura me pedagogë të ftuar francez apo studiues vendas në funksion të diversifikimit të formave të mësimdhënies dhe mësimnxënies.
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	Personeli akademik, përtej respektimit të rregullave të institucionit, duket se ka kërkesa të vazhdueshme në drejtim të përmirësimit të lëndës/modulit me një literaturë të 5 viteve të fundit, gjithashtu liria akademike në drejtim të organizimit të orëve mësimore sipas nevojave dhe nivelit të studentit i jep mundësi pedagogut të aplikojë forma ndërveprimi që nxisin të menduarit kritik mbi çështje të caktuara.  Në kushtet e pandemisë, përdorimi i platformave Google Classroom, Teams lehtësuan procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formuese dhe kërkesat e punëdhënësve.	UT mbështet personelin akademik, me rregullore dhe veprimtari konkrete në aspektin didaktik (E:3.8 technology training for FGJH)
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Pas konsultimit të planit mësimor, listës emërore, e CV-e të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, dhe profilit të tyre të kualifikimit në fushën akademike dhe kërkimore, GVJ vlerëson titujt, gradat shkencore, specializimet si një një element shumë pozitiv për një mësimdhënie cilësore dhe aftësi akademike në transmetimin e njohurive tek studentet. Përsa i përket metodologjisë në mësimdhënie, duke iu referuar syllabuseve, diskutimeve me studentët dhe stafin akademik vërehet se metodat e mësimdhënies variojnë sipas lëndëve dhe tematikave të ndryshme.
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në	UT dhe FGJH/departamenti i gjuhës frënge, i cili administron programin e studimit BA në Gjuhë frënge, ka të ligjëruar në strategjinë e vet kërkësën për përmirësim të mësimdhënies ku në fokus është edhe respektimi i mendimit të studentëve.

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)





këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	GVJ vlerëson raportin vjeor të NjSBC dhe punën e kësaj njësie për monitorimin e këtij procesi. Rekomandimet e raportit për përmirësime të aspekteve të ndryshme të cilësisë së mësimdhënies apo performancës së stafit akademik apo programeve mësimore tregojnë seriozitet dhe ambicje për një perfeksionim në këtë drejtim.
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.	Nga vlersimi i mënyrës sesi janë hartuar silabuset ka larmishmëri përsa i përket formave të përdorura në mësimdhënie kryesisht metoda interaktive ku rëndësi merr pjesëmarrja e studentëve dhe puna e tyre individuale me detyra kursi, projekte, ese etj. Këto forma i përshtaten shumë mirë disiplinave të shkencave humane dhe ndihmojnë studentin të fitojë njohuri praktike mbi fushat e ndryshme të këtyre disiplinave.  Gjithashtu, nga studentët pati në përgjithësi komente pozitive për pedagogët, mbi formën e realizimit të leksioneve metodologjisë së mësimdhënies.
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Duke u mbështetur në rregulloret dhe udhëzimet e institucionit apo nga informacionin e marrë nga takimi me studentët dhe pedagogët, respektohet dinjteti dhe integriteti i çdo studentit. Procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies realizohet në një klimë pozitive dhe liria e mendimit respektohet duke krijuar kushte të favorshme që stimulojnë arsyetimin e thellë e të menduarit kritik të studentit.
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	X

<b>Standardi III.3</b> Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësinë profesionale duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Pas konsultimit të skedës së infrastrukturës (E: 4.6 tab 16) dhe vizitës në mjediset e FGJH-së, GVJ vëren se institucioni ka një infrastrukturë fizike të nevojshme për realizimin e procesit mësimor. Sipërfaqja është e mjaftueshme, me salla për leksione/seminare/laboratore përkthimi me kapacitetin e nevojshëm për numrin e studentëve të këtij program studimi. Këto mjedise janë të pastra dhe mirëmbahen mjaft mirë.
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Sallat/laboratori i përkthimit në mbështetje të procesit mësimor janë brenda standardeve, kanë logjistikën e nevojshme për realizimin e procesit mësimor, si kompjutera, videoprojektor, ekrane projektimi, monitorë, pajisje përkthimi etj, Internet duke bërë të mundur që mësimdhënia të zhvillohet me metoda e teknologji bashkëkohore dhe në përputhje me specifikat e lëndëve. GVJ vlerëson planifikimin në fillim të çdo semestri të përdorimit të laboratorit të përkthimit si dhe shpenzimet e kryera sipas buxhetit për përmirësimin e infrastrukturës. (E: 3.35,4.31)
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Departamenti i Gjuhës frënge ka një mjedis të bollshëm në shërbim të stafit, i pajisur me mjete të nevojshme informatike (kompjutera, printera, skanera, fotokopje etj).  Mjediset e bibliotekës dhe Qendrës frankofone (CNF) janë të pajisura gjithashtu me kompjutera dhe akses internet duke lehtësuar punën e studentëve për hulumtimin e literaturës që lidhet me procesin mësimor.  Institucioni ofron për stafin dhe studentët bibliotekat online për qëllime të shfrytëzimit

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)





	<p>të literaturës për nevoja të stafit akademik dhe të studentëve.</p> <p>FGJH ka siguruar nje komunikim mes stafit akademik dhe administrative nëpërmjet domenit zyrtar të UT-së dhe zyra e IT mbulon problemet informatike.</p> <p>Gjatë situatës së pandemisë, u përdor sistemi “Microsoft Teams” i cili mundësoi realizimin e procesit mësimor duke mundësuar komunikimin pedagog-student, konsultimin me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive. Ambientet janë të mbuluara me sinjal ëifi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht ëeb. Pedagogët dhe studentët shprehen se shpesh i kanë konsultuar burimet e literaturës online për nevojat e tyre akademike.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë është në në gjuhën frënge, e cila është dhe gjuha e realizimit të këtij programi studimi dhe duke iu referuar syllabuseve të lëndëve mësimore GVJ vlerëson shumëllojshmërinë e saj si për literaturën e detyruar dhe atë të rekomanduar. Duke parë titujt dhe nga bisedat me studentët mendojmë se kjo literaturë garanton përfitim të dijeve nga ana e studentëve. (E : 2.16,1.11)</p> <p>GVJ vlerëson si një përpjekje pozitive faktin se UT ka mundësuar akses pa pagesë edhe në e biblioteka online, psh, JSTOR, Cobis, U-Library.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja funksion një bibliotekë me hapësira të mjaftueshme për studentët dhe pedagogët, me një fond të pasur në gjuhë të ndryshme (15965) nga i cili 4772 tituj në gjuhën frënge, i cili pasurohet herë pas here me blerje/hyrje të reja në varësi të nevojave të evidentuara nga departamenti, por me nje sasi të vogël.</p> <p>Botimet në dispozicion të programit të studimit sipas të dhënave të bibliotekës dhe vizitës në këtë bibliotekë janë të fushave të ndryshme, por pjesa më e madhe e disa viteve më përpara.</p> <p><i>GVJ sugjeron një që blerjet e reja të jenë në numër më të madh për njësi duke mundësuar konsultim më të gjërë nga studentët e pedagogët.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët kanë akses në bibliotekën online JSTOR, fondi i së cilës është shumë i pasur jo vetëm me libër por edhe me artikuj në revista shkencore.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Biblioteka e FGJH-së dhe akseset e siguruar ne platformat online mundësojnë marrjen e informacionit të nevojshem për te realizuar kerkime dhe studime nga burime dytesore mbi detyrat e kursit, esete, etj. GVJ vlerëson angazhimin e stafit akademik dhe ndihmës akademik për realizimin e oreve të konsultimit, orientimit dhe drejtimit të vazhdueshëm të punëve të studentëve.</p> <p>4 laboratorët për lëndë të ndryshme dhe laborator i përkthimit lehtësojnë studimin, kërkimet dhe punën individuale ose në grup të studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Kushtëzuar nga situatë e pandemisë, institucioni ka favorizuar përdorimin e disa platformave e-learning si google classroom, zoom por kryesisht “Microsoft Teams” duke bërë të mundur zhvillimin e mësimin dhe azhurnimin e studentit me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audiovizive etj.</p> <p>Ambientet janë të mbuluara me sinjal ëifi në mënyrë që pedagogët dhe studentët të aksesojnë lirisht ëeb. Ata shprehen se shpesh i kanë konsultuar burimet e literaturës online për nevojat e tyre akademike.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të</p>	<p>GVJ konstaton komunikimin mes stafit akademik, ndihmës akademik dhe studentëve nëpërmjet adresave elektronike zyrtare duke mundësuar informimin në kohë reale.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.asc.al](http://www.asc.al)

E-mail: [info@asc.al](mailto:info@asc.al)







<p>brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Pëmes këtij sistemi secili prej përdoruesve në çdo kohë dhe vend informohet në lidhje me procesin mësimor, sezonin e provimeve, pikët e grumbulluara në lëndë e module të ndryshme etj. Ky sistem i brendshëm komunikimi shihet si tepër efektiv në drejtim të rrijës së aksesit në burimet e brendshme të informacionit si nga ana e stafit dhe e studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Në përfundim të vitit III studentët i nënshtrohen një provimi formimi, i cili vlerëson njohuritë e marra gjatë 3 viteve të studimit. Departamenti i gjuhës frënge nuk ka të parashikuar përgatitjen e nje teme diplome ne përfundim të studimeve Bachelor.</p>
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.4</b>  <b>Institucioni ngrit struktura të personave në nivel institucional të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimdhënies në programet e studimit.</b></p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Në bazë të strukturës së UT-së vlerësojmë faktin se institucioni ka ngritur struktura si Drejtoria e kurrikulave dhe sigurimi i cilësisë, Drejtoria e teknologjisë, inovacionit dhe statistikave, Drejtoria e kërkimit shkencor, projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë, të cilat monitorojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies duke përshtatur kurrikulën e programeve të studimit me standartet shtetërore dhe ato ndërkombëtare. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka ngritur njësinë e sigurimit të cilësisë, strukturë e cila edhe pse është ngritur në korrik 2021, ka ndërmarrë disa nisma që synojnë të ndihmojnë institucionin në këtë drejtim. NJSBC bashkëpunon me autoritetet dhe strukturat përkatëse nëpërmjet kordinatorit (takimi me NJSBC).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Njësia kryesore dhe ajo bazë në bashkëpunim me zyrën e sigurimit të cilësisë ka ndërmarrë disa nisma që synojnë të ndihmojnë institucionin në këtë drejtim. Raporti vjetor i veprimtarisë së programit të studimit dhe rezultatet e pyetësorëve bëjnë të mundur që të mblidhet një informacion i detajuar mbi një sër aspektesh të rëndësishme duke monitoruar zgjidhjen e problematikave të mundshme. Gjatë vizitës u evidentua se edhe grupi i sigurimit të cilësisë në nivel departamenti monitoron programin në vijimësi, duke u siguruar informacione të rëndësishme si zyrës së sigurimit të cilësisë në nivel institucional ashtu edhe njësisë kryesore dhe asaj bazë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit GVJ vëren se strukturat dhe njësia bazë inkurajojnë format e reja dhe inovative në mësimdhënie përmes aktivitete kërkimore-shkencore ose trajnuese/orientuese për eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative. (E: 3.6). Vlerësojmë trajnimin e pedagogëve për përdorimin e tabelave interaktive apo përdorimin e platformës Teams për mësimdhënie, shkëmbim materiale apo aktivitete të tjera akademike.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin e Drejtorisë së kërkimit shkencor, projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë, zv-dekanin për kërkimin shkencor u vu re që FGJH mbështet personelin akademik ndihmës akademik për kualifikime të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor. Pedagogët e këtij programi studimi kanë marrë pjesë në konferenca shkencore apo mobilitete në kuadër të programit ERASMUS+, si dhe institucioni u ka krijuar mundësinë për publikim në revistën shkencore "FGJH" duke promovuar punën e tyre shkencore. (E: 3.12, E: 3.17, E :3.18).Pedagogët dëshmojnë se një herë në dy vite kanë të drejtë të marrin financim nga institucioni për veprimtari shkencore (E :3.15) ose kanë qenë pjesëmarrës në projekte shkencore të hartuara nga vetë ata.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin</p>	<p>Departamenti i Gjuhës frënge, duke u mbështetur në nevojën e rritjes së cilësisë në mësimdhënie ka realizuar disa aktivitete me fokus trajnimin e stafit në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë i sigurojnë trajnim të vazhdueshëm për</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)





akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja duke ftuar trajnues/lektorë vendas dhe të huaj (E1.17, E1.18, E4.9). GVJ vlerëson faktin se në këto programe trajnimi është përfshirë personeli akademik efektiv, duke realizuar/drejtuar procesin trajnues, ose leksionet e hapura duke përfutur edhe nga Projektet ndërkombëtare Erasmus +, KAI etj.
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Në zbatim edhe të dispozitave statuore të UT-së, personeli i angazhuar në këtë program studimi përmirësohet vazhdimisht, duke ngritur shkallën e kualifikimit në përputhje me lëndët apo modulet që mbulojnë, përditësimin e programeve lëndore dhe literaturës, përdorimin e teknologjive të reja në mësimdhënie. Raporti vjetor i veprimtarisë së departamentit dhe bisedat me stafin akademik dhe ndihmës e dokumentojnë këtë fakt.
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e prishmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Në lidhje me këtë kriter, GVJ vlerëson zhvillimin e procesit mësimor me tabela interaktive të cilat u evidencuan edhe gjatë vizitës në fakultet, të cilat mundësojnë një mësimdhënie më cilësore dhe motivuese për studentët. Vërtetohet gjithashtu se ndiqet nga institucioni edhe monitorimi i procesit të mësimdhënies përmes mbledhjeve të përmuajshme të departamentit, ku diskutohen mbi këto metoda, formatit të vlerësimit të pedagogut nga studenti, dhe formularit të vlerësimit të performancës, procedura që synojnë nxitjen e kërkesave personale në drejtim të rritjes profesionale të stafit të angazhuar në mësimdhënie.
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>X</b>

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive shkencore e profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloren mësimore të programit të studimit, dhe u bëhen publike në kohë reale për studentët nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të FGJH-së si dhe në orët e para të mësimit për çdo lëndë, fakt i cili u vertetua edhe nga biseda me studentët. (E2.1.1)  Verifikimi i syllabuseve vërteton se njohuritë e përfutura nga studenti kontrollohen dhe vlerësohen me pikë përmes një kombinimi të frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimit në auditor, provimeve me shkrim, eseve/detyrave të kursit, të bëra publike nga çdo pedagog dhe që janë të detyrueshme për zbatim (E3.24)  Një mënyrë e tillë vlerësimi dhe për qëllim: nxitjen e studentit që të mësojë gjatë gjithë vitit, realizimin e një vlerësimi më objektiv të studentit, duke e ndarë notën në disa komponentë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim. Aplikimi i kësaj praktike për testim dhe vlerësim shihet si pozitive në drejtim të një objektiviteti në vlerësimin e performancës akademike të studentit.
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Gjatë bisedave me studentët vërtetohet se çdo pedagog në fillim të lëndës i njih studentët me përmbajtjen e lëndës, kreditet, vendin që zë lënda në formimin tërësor të studentit, ngarkesa në auditor dhe jashtë tij, njohuritë dhe aftësitë që i jep studentit kjo lëndë, format dhe metodat e mësimdhënies, raportet midis tyre, detyrimet e studentit për lëndën, format e vlerësimit të studentëve, si dhe literatura e detyruar dhe ajo e rekomanduar. Në mbështetje të kësaj procedure janë hartuar broshura informative/udhërrefyeshit, si dhe organizohet java e orientimit (E5.9)

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.asc.al](http://www.asc.al)

E-mail: [info@asc.al](mailto:info@asc.al)





<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Studentit i jepen hapësirat e nevojshme për të demonstruar përvetësimin e njohurive përmes mendimeve dhe reflektimeve personale të shpalosura në auditor (vlerësimi i vazhduar), vlerësimi nga detyrat e kursit, testit të ndërmjetëm dhe final me diversitet pyetjesh dhe formash të nxitjes së të nxënit.</p> <p>Elementet kryesore të kontrollit të vazhdueshëm mësohet të jenë: angazhimi gjatë seminareve, testet e ndërmjetme, detyrat e kursit/detyrat praktike dhe niveli i aktivizimit në seminare. Provimi synon vlerësimin e njohurive dhe të aftësive argumentuese të studentëve dhe janë me shkrim ose me gojë. Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e dijeve janë : Provimi i ndërmjetëm, Provimi përfundimtar, Riprovimi, Përmirësimi, Diploma.</p>				
<p><b>Shtylla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <tr> <td style="width: 25%;"></td> <td style="width: 25%;"></td> <td style="width: 25%;"></td> <td style="width: 25%; text-align: center;">X</td> </tr> </table>				X
			X		

<p><b>Standardi III.6</b> <b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Mbështetur në procedurën e përcaktuar në rregulloren e programit të studimit (E: 2.1.1) shprehur qartë edhe në syllabuset e çdo lënde/moduli vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe ka qëllim: nxitjen e studentit që të mësojë gjatë gjithë vitit, realizimi i një vlerësimi më objektiv të studentit, duke e ndarë notën në disa komponentë. Aplikimi i këtij sistemi të integruar të vlerësimit, i cili u evidentua edhe gjatë bisedës me studentët dhe pedagogët gjatë vizitës në institucion shihet si pozitiv në drejtim të një objektiviteti në vlerësimin e performancës akademike të studentit.</p> <p>Po kështu ato shihen si mundësi nga pedagogu për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, të cilat duhen trajtuar me prioritet gjatë zhvillimit të lëndës/modulit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Ashtu sic parashikohet në statutin e UT-së (E: 1.8) dhe rregulloren specifike të provimeve (E: 3.2), për të siguruar transparencën dhe objektivitetin në vlerësimin e njohurive të studentëve dhe për të shmangur rastet e subjektivitetit, UT në bashkëpunim me AADF ka vënë në dispozicion sistemin clean score të korrigjimit të provimeve nëpërmjet sistemeve informatike të teknologjisë, i cili mund të përdoret varësisht specifikave të fushave të studimit si dhe kërkesave të pedagogëve. (E: 3.25). Gjithashtu, përgjatë periudhës së spostimit të procesit mësimor në platformën e-learning office 365 sistemi mundësonte në mënyrë automatike gjenerimin e korrigjimit për pyetjet e mbyllura.</p> <p><i>GVJ evidenton se nuk ka evidencë për realizimin e testimit përmes sistemit elektronik.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Departamenti i gjuhës frënge, ka një procedurë të mirëorganizuar për përgatitjen e tezës së provimit nga pedagogu i lëndës dhe miratimin nga përgjegjësi i departamentit. Disa prej këtyre aspekteve kanë të bëjnë me respektimin e formatit të miratuar (E: 3.26, E: 3.27), përditësimin e përvitshëm dhe dorëzimin të paktën një ditë përpara zhvillimit të provimit për t'u miratuar nga Përgjegjësi i njësisë bazë.</p> <p>Gjatë bisedave me stafin GVJ evidentoi se komisionet e provimeve ngrihen dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit, në përbërje të të cilit duhet të jenë pedagogu i lëndës dhe një anëtar i stafit akademik. Mbrojta e diplomave realizohet me komision prej dy ose më shumë anëtarësh.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me</p>	<p>Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim nga ana e personelit ndihmës akademik të departamentit që bën</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)





sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	sekretimin e tezave. (E: 1.8). Me përjashtim të pedagogut të lëndës, të monitoruesve të ngarkuar nga drejtuesi i departamentit, në sallën e provimit nuk lejohet që të hyjnë persona të tjerë. Në kushtet e pandemisë u aplikua testimi on line (E: 3.25).
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Në lidhje me komentet apo feedback-un mbi rezultatet e testimit nuk kemi evidencë për të gjykuar plotësisht mbi këtë aspekt, por ka procedura të mirëorganizuar për mënyrën sesi realizohet vlerësimi. Pedagogu i lëndës pas korigjimit të tezës së provimit ia vë në dispozicion studentit, nëse dëshiron të qartësohet dhe të ankimojë rezultatin sipas rregullores në fuqi. (E:1.8, E: 2.1.1)
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Në zbatim të Rregullores së Përgjithshme të UT-së dhe asaj të programit të studimit në fjalë, në syllabuset e çdo lënde/moduli hasim shënimin mbi ndalimin e kopjimit, plagjiaturës apo fabrikimit të të dhënave.
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Institucioni disponon një procedurë të mirëfilltë përsa i përket gjithë procesit që lidhet me procedurat e hartimit të tezës së provimit, vlerësimit, shpalljes së rezultateve dhe ankimit nga ana e studentit.  Procedura që zbatohet përfshin rregullat sesi bëhet kontrolli i vazhdueshëm i dijeve, hyrjen në provim dhe gjithçka tjetër që i përket këtij procesi të përcaktuar në rregulloren e programit të studimit dhe në syllabusin e lëndës.
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Nga takimet në institucion vërejmë se respektohen procedurat e njohjen me vlerësimin, kushtet dhe hapat për rishikimin e vlerësimit. Këto procedura janë konform legjislacionit në fuqi dhe rregullores së UT-së dhe asaj së programit të studimit. (E :1.8)  Institucioni garanton të drejtat e studentëve për rishikim të vlerësimit. Përgjegjësi i departamentit shqyrton kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit duke vënë në dijeni edhe dekanin dhe duke ngritur një komision ad-hoc i cili jep vlerësimin përfundimtar.
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Duke u bazuar te rregullorja e UT-së si edhe te rregullorja e programit të studimit ekziston një procedurë, e cila u jep mundësi studentëve të ndjekin këtë proces në mënyrë korrekte. Rivlerësimi i testimit bëhet nga një komision i posaçëm konform rregullave ligjore dhe në mbështetje të të drejtave të studentit. Nuk ka evidencë për një rast të tillë.
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	X

<b>Standardi III.7</b>	
<b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentit, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Pas konsultimit të evidencave përkatëse (E: 2.19) dhe diskutimit me stafin gjatë vizitës në FGJH rezulton se programi i studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim ka një koherencë në përmbajtje mes lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese, formuese, duke u dhënë mundësi studentëve të

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.asc.al](http://www.asc.al)

E-mail: [info@asc.al](mailto:info@asc.al)





	zgjerojnë njohuritë shkencore sipas disiplinave dhe zhvillojnë aftësitë profesionale.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Institucioni dhe ky program studimi synojnë krijimin e kushteve që studentët të zhvillojnë aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit në aspektin praktik. Vlen të përmenden trajnimet për të përdorur sistemin "Microsoft Teams" dhe sitemin online të shfrytëzimit të literaturës në bibliotekat online. Në drejtim të komunikimit dhe ndërveprimit plani mësimor ka një sërë lëndësh dedikuar komunikimit dhe zhvillimit të aftësive ndërkulturore. po kështu edhe gjatë bisedave me studentët vlerësojmë aktivitetet e shumta me fokus këto aspekte. Planu mësimor i nënshtrohet një procedure transparente për ndryshime (E: 2.11)
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Në këtë drejtim GVJ vëren nismën e njësisë bazë, e cila realizon në mënyrë periodike analizën e punës, ku kërkon në fund të semestrit nga pedagogu i çdo lënde apo moduli një analizë të punës në lidhje me objektivat e arritura të lëndës si dhe rekomandimet në lidhje me të ardhmen. Prezenca e këtyre praktikave në institucion shihet si element pozitiv në drejtim të përpjekjeve për të ofruar lëndë e module që synojnë zhvillimin e kompetencave dhe aftësitë e studentëve.
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Në lidhje me aplikimin e këtij standarti biseda me studentët na jep informacion mbi orientimin e studentëve para provimeve nga secili prej personelit akademik që është angazhuar në këtë program studimi. Pedagogu i çdo lëndë në fund të semestrit para provimit përfundimtarë realizon seancë konsultimi me studentët për çështjet kryesore të trajtuara gjatë lëndës/modulit dhe orienton studentin për provimin përfundimtar, strukturën e vlerësimit në provim dhe atij përfundimtar.
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Në këtë drejtim institucioni ka praktika të mira përse i përket hapësirave që ka stafi akademik për të përfiturar nga evente të ndryshme, të cilat realizohen përgjatë vitit akademik, si konferenca, simpoziume, leksione të hapura me të ftuar dhe personalitete të larta të vendit dhe të huaj, veprimtari promovuese. Kemi mjaftueshëm evidenca që tregojnë se personeli akademik dhe studentët janë të angazhuar në pjesëmarrjen në këto veprimtari (E: 3.11)
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Përse i përket mundësisë për zhvillimin e mësimdhënies mbi llogarë kompetencash ka evidenca që na ndihmojnë të gjykojmë mbi këtë aspekt. Disa module të lëndëve karakterizuese kanë karakter praktik dhe përgatisin studentët për praktikën profesionale në nivelin master. (E: 52.27)
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Duke u bazuar në mënyrën e ndërtimit të syllabuseve të lëndëve/module (E: 2.1.6) por edhe nga takimet e realizuara me stafin akademik dhe studentët, duket se përbushet plotësisht ky kriter, pasi mësimdhënia bazohet në diskutimet e ndryshme, nxitjen e mendimit kritik mbi çështjet që trajtohen duke e vendosur studentit në një pozicion aktiv në drejtim të përvetësimit të dijeve dhe të nxënit në tërësi. Për vetë karakterin e lëndëve GVJ vlerëson ushtrimet në grup, detyrat e kursi apo ekspozetë.
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Ky element duhet parë në vijimësi me kriterin 9, pasi personeli akademik ka në fokus të mbështetjen e studentëve për idetë inovative apo studimet e avancuara kërkimore e shkencore, referuar edhe evidencave 1.11/1.12/3.29 mbi veprimtaritë ekstrakurrikulare me karakter kulturor, shkencor, sportive apo zbatimës të organizuara në FGJH.
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Bazuar në disa evidenca (E: 3.30/3.31/3) GVJ vlerëson përfshirjen në aktivitete të përbashkëta apo projekte në bashkëpunim me pedagogët. Vlerësohet mbështetja financiare e siguruar nga institucioni.(E: 1.1/E.1.12)
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik	Përse i përket bashkëpunimit me instiucionet e tjera, FGJH ka bashkëpunime të

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)





ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	mira me aktorë të shumtë në sektorin publik apo privat, shoqërinë civile apo organizata profesionale duke rritur hapësirat për mobilitet të studentëve. (E: 2.27/E: 4.7)
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	

<b>Standardi III.8</b> <b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Bazuar në rregulloren mësimore të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim, departamenti ka hartuar një procedurë të posaçme për provimin e formimit duke filluar nga programi (E5.19), rregullat që duhet të ndiqen të cilat u bëhen të ditura studentëve. Kjo vërtetohet edhe nga bisedat me stafin dhe studentët.
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Personeli akademik vë në dispozicion të studentëve informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në ndihmë të përgatitjes për provimin e formimit dhe komisioni i miratuar në departament harton tezën mbi bazën e bankës së pyetjeve të cilat janë bërë të njohura tashmë për studentët. (E: 3.34) Monitorimin e zbatimit të këtyre procedurave e realizon njësia bazë.
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Bazuar në Rregulloren e FGJH-së, komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tre viteve akademike, duke përfshirë të gjitha njohuritë e fituara në lëndët/ modulet. (E: 3.34)
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët përgatitjen e provimit të formimit gjatë orëve të leksioneve, seminareve por edhe janë përcaktuar orë konsultimesh me pedagogët (E: 5.39) GVJ vlerëson këtë procedurë të përcaktuar nga rregullorja e programit të studimit dhe monitoruar nga njësia bazë, e cila detyron studentin dhe pedagogun në realizimin e seancave të konsultimit individual.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Ky kriter nuk zbatohet pasi vlerësimi përfundimtar i studentëve kryhet me anë të provimit përfundimtar.
<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Ky kriter nuk zbatohet pasi vlerësimi përfundimtar i studentëve kryhet me anë të provimit përfundimtar.

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)




<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Bazuar në rregulloren e institucionit dhe rregulloren e brendshme të programit të studimit vlerësimi i studentëve në përfundim të provimit të formimit realizohet para komisionit të diplomimit dhe vlerësohet me notë nga ky komision i cili u bën të ditur studentëve dhe e depoziton atë në sekretarinë mësimore.
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Bazuar në Rregulloren e UT dhe programit të studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim, në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën, listen e notave dhe suplementin e diplomës. Kjo formë e paraqitjes së diplomës është konform dokumentacionit që shoqëron këtë rrugëtim profesional të studentëve. Ky kualifikim emërtohet në të njëjtën formë si në modelin e diplomës dhe në listen e notave e suplementin e diplomës dhe janë të unifikuara dhe me emërtimin, me të cilin programi ka marrë vendimin për organizim të tij nga MAS.
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve një kopje zyrtare të syllabuseve të këtij programi studimin në varësi të kërkesës së bërë dhe për interesa të vetë studentit. Gjithashtu, Sekretaria Mësimore harton dhe pajis studentin me Suplementin e Diplomës, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur.
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Institucioni për ruajtjen dhe arkivimin e informacionit dhe paisjen e studentit me informacionin e nevojshëm ndjek rregullat që i dikton legjislacioni. Pas përfundimit të studimeve nga studenti, një kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Nga takimi me aktorët përkatës mësohet se institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vet institucionit.
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	
	X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	
	X


#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program	Siç rezulton nga evidencat (E: 1.15) dhe takimet me personelin e këtyre strukturave, Dega e burimeve njerëzore dhe Dega e Protokoll-Arshivës janë struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në këtë program studimi. Stafit akademik dhe ndihmës kanë dosjet personale me të dhëna të plota. Zyrë e Burimeve njerëzore merret me

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)







dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.	procedurat e rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme si dhe me stafin ndihmës akademik, të cilat na rezultojnë të plota pas konsultimit të dosjeve gjatë vizitës në institucion. Ajo menaxhon vazhdimisht dhe përditëson bazën e të dhënave të stafit akademik, ndihmës mësimor, ndihmës akademik dhe stafit administrativ Secili anëtar i stafit akademik, përditëson CV-në e tij periodikisht si në Dosje, dhe në profilin përkatës në faqen elektronike të FGJH-së.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Institucioni ka një procedurë rekrutimi për personelin akademik shprehur në Statutin e UT-së (E: 1.1) dhe Rregulloren e UT (E: 1.8) Ato janë të mbështetura në Kodin e Punës dhe në Statusin e personelit akademik (E: 4.4). Dega e Burimeve Njerëzore (FGJH) ndjek procedurat e përcaktuara në statut (E: 4.3). Fazat kalojnë nga shpallja e thirrjes online, përgatitja e listave për komisionin e rekrutimit, i cili merr vendimi, në bazë të kriterëve të përcaktuara nga baza ligjore në fuqi, mbi rregullat dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik.(E.1.1)
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriterëve të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	GVJ vlerëson se procedurat e përcaktuara nga institucioni në lidhje me afatet, kriteret e përgjithshme dhe specifike për tu bërë pjesë e stafit akademik të FGJH janë konform rregullores për burimet njerëzore dhe rregullores së institucionit dhe në linjë me udhëzimet dhe legjislacionin për arsimin e lartë në vend. Kriteret shpallen publikisht në Buletin e Angjencisë së Prokurimeve Publike. Njoftimi përmban kriteret bazë dhe specifike të vendit të punës, dokumentacionin që aplikanti duhet të dorëzojë dhe afatet e aplikimit (E: 4.3) Kriteret e rekrutimit të personelit akademik publikohen në faqen zyrtare ëeb pas identifikimit të nevojave.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Institucioni ndjek procedura rekrutimi sipas të gjitha kriterëve të shpalljeve publike përmes mjeteve të komunikimit që insitucioni ka në dispozicioni, faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik “Buletini i njoftimeve publike” (E: 4.3). Këto procedura kryhen nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori Protokoll-Arshivës në bashkëpunim me DGJF. Përzgjedhja e fituesve bëhet me konkurim të hapur përmes një procesi transparent. Vlerësimi bëhet mbështetur në thirrjen ku përfshihen kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Ngrihet një komision ad hoc me 5 anëtarë, i përbërë nga pedagogë dhe punonjës kërkimorë-shkencorë të brendshëm, të cilët bëjnë përzgjedhjen përfundimtare të personelit akademik Komisioni ndjek procedurat e parashikuara në Manualin e punësimit (E: 4.2) dhe më pas bëhet emërimi i personelit nga Rektori dhe lidhet kontratë me punëdhënësin (E: 1.1)
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmirësimi i përbashkët</b>
	X

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	FGJH angazhohet në drejtim të përmirësimit të kushteve të përshtatshme për të realizuara detyrat e gjithsecilit sipas rolit dhe përgjegjësisë. Bazuar në informacionet e marra nga takimet me stafin si dhe nga informacioni i siguruar nga RVB rezultojnë se kapacitetet infrastrukturorë (E:4.6/4.1/4.13/4.14) në dispozicion, sallat e departamenteve, zyrat, zyrat individuale të drejtuesve, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme (poste pune, kompjuter, sistem kondicionimi dhe ndriçimi) janë tregues të një mjedisi të përshtatshëm. GVJ vlerëson se mësimi fizikisht në auditor apo në Teams zhvillohet në përputhje

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.asc.al](http://www.asc.al)

E-mail: [info@asc.al](mailto:info@asc.al)






	me rregulloret e brendshme si dhe ligjet në fuqi. Këto sigurojnë krijimin e mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Nga informacioni i RVB dhe bisedat me stafin drejtues dhe akademik rezultojnë se FGJH ka nxitur kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimit të mëtejshëm profesional të stafit efektiv në universitete perëndimore në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit të UT/FGJH me universitete ndërkombëtare, projekte mësimore-shkencore dhe bursave vetjake si: Erasmus+, Fulbright, Mevlana, marrëveshje AUF etj. trainime në kurse specifike etj. (E4.7) Në janar të 2022, Komisioni Europian i ka akorduar UT logon "HR EXCELLENCE IN RESEARCH". Kjo logo certifikon se UT është angazhuar dhe ka krijuar një mjedis pune nxitës dhe profesional për kërkuesit shkencorë. Logo "HR EXCELLENCE IN RESEARCH" i jep njohje publike Universitetit të Tiranës dhe mundësinë për të shtuar aplikimet për grant-e të ndryshme në fushën e kërkimit dhe mësimdhënies. Në kuadër të veprimtarisë kërkimore, FGJH organizon konferenca të ndryshme shkencore dhe i mundëson stafit akademik publikimin e artikujve apo kumtesave shkencore në revistat e FGJH-së. Ajo realizon gjithashtu edhe trajnime të ndryshme për përmirësimin e aftësive profesionale dhe metodologjike të pedagogëve. (E: 1.20)
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	GVJ konstatoi se institucioni disponon Udhëzuesin për Programin "UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion" (E4.8) nëpërmjet të cilit UT synon të mbështesë Njësitë Kryesore dhe Njësitë Bazë në fushat e kërkimit dhe të inovacionit. Rezultatet e kërkimit përdoren më tej në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Po kështu, UT ka miratuar, udhëzuesin për përdorimin e sistemit të mësimin në distancë, mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve <i>online</i> , përdorur intensivisht gjatë viteve akademike 2019-2020, 2020-2021 për të gjitha lëndët e programit Bachelor në "Gjuhë Frënge". Ky udhëzues mundëson përdorimin e një sistemi digjital të përparuar si një metodë krijuese e mësimdhënies. (E: 4.9)  Personeli akademik i DGJF ka marrë pjesë në programe të ndryshme të trajnimit organizuar nga "Qendra virtuale e trajnimit dhe zhvillimit profesional", (E 2.1.7), në ëbeinare, trajnime fizike të cilat kanë patur në fokus sfidat e reja në fusha të specializuara të mësimdhënies, përkthim-interpretimit, komunikimit ndërkulturor dhe turistik etj., promovimin e metodave inovative të mësimdhënies, qasje drejt teknologjive të reja etj. (E: 1.20), (E : 4.15)
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Institucioni është i angazhuar në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm pune dhe me mundësi të barabarta për të gjithë personelin e angazhuar Bazuar në informacionin e dosjes së vet-vlerësimit dhe takimeve apo informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se DGJF ka staf me tituj e grada, organizon punën e stafit akademik në shërbim të aktiviteteve mësimore e kërkimore, duke kryer ndarjen optimale të ngarkesës mësimore dhe asaj kërkimore shkencore sipas kompetencave profesionale të secilit pedagog dhe planifikimit vjetor të kohës së punës. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për personelin ndihmës akademik që kujdesen për shërbimet në FGJ dhe sekretarja e departamentit që administron të gjithë dokumentacionin pranë zyrës përkatëse të departamentit, si dhe ndërmjetëson për komunikimin me personelin, studentët apo të interesuar të tjerë për çështje që lidhen me veprimtarinë mësimore- kërkimore të departamentit. FGJH ka gjithashtu staf administrativ në përbërje të tij me personelin të dedikuar për shërbimet në FGJH. (E : 1.15 ], (E : 4.10, 4.11).
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	
	X


**Standardi IV.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.asc.al](http://www.asc.al)

E-mail: [info@asc.al](mailto:info@asc.al)





e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Nga informacioni i RVB-së dhe vizita në institucion rezulton se FGJH përmbush këtë kriter nga pikëpamja e sipërfaqes dhe mjediseve të nevojshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. Mjediset e godinave plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral. Mësimi në Programin e studimit bachelor në Gjuhë frënge” zhvillohet ka në dispozicion salla leksioni, seminari, zyra salla laboratorit të cilat kanë infrastrukturën e duhur për një proces normal të të nxën. Të gjitha sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me videoprojektor, laptop, ëhiteboard, platform online dhe të gjitha mjetet e tjera logjistike.</p> <p>Programi i Bachelor në “Gjuhë Frënge” shfrytëzon 4 mjedise laboratoresh dhe sallën e Agjencisë Universitare të Frankofonisë (AUF) e cila është gjithashtu një mjedis i pajisur me infrastrukturë teknologjike dhe me lidhje të vazhdueshme me Internetin. (E : 4.12, 4.14)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Vizita në institucion konfirmon se mjediset mësimore janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, të tilla si tabela ëhiteboard dhe smartboard, ëireless, të cilat mundësojnë zhvillimin e mësimin në kushte bashkëkohore. Mjetet audio-pamore janë të instaluar në mënyrë të përhershme në pjesën më të madhe të auditorëve. Të gjitha ndërtesat e FGJH kanë kushte për të përdorur rrjetin fikse të internetit. Në klasat e seminareve pa videoprojektorë të përhershëm përdoren mjetet audiopamore që janë të depozituara në departament për të kryer prezantime, detyra, projekte kursi. Sallat (klasat e seminareve dhe të leksioneve) dhe laboratorët mësimorë janë pajisur me tabela interaktive dhe më shumë se 60 kompjutera. (E : 4.12, 4.13, 4.14)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>FGJH ka gjithashtu në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve dy salla për zhvillimin e lëndëve specifike të përkthim-interpretimit, të fonetikës si dhe një sallë multimedia. Së fundmi sallat janë pajisur edhe me tabela interaktive dixhitale të lidhura me Internetin. (E: 4.12, 4.13, 4.14)</p> <p>Referuar Buxheteve të FGJH, janë bërë vazhdimisht investime në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës. (E :4.31, 4.32)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Në funksion të mësimdhënies në programin Bachelor në “Gjuhë Frënge” janë dy laboratorë të teknologjisë së informacionit me pajisje specifike për zhvillimin e lëndëve të interpretimit, laboratorit mësimor i Fonetikës i pajisur me softëare të vecantë për zhvillimin e shqiptimit në gjuhë të huaj si dhe salla multimedia. Të katër laboratorët janë të pajisur me kompjutera me softëare dhe një seri programesh dhe paketash elektronike. Programet profesionale që ofrohen janë, Sistemet Operative Ëindoës, Paketa Microsoft Office, Sistemi operativ Linux, etj. (E : 4.12, 4.13, 4.14)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>GVJ vëren se në programin e studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim nuk parashikohen praktika mësimore. (E : 2.13), por në nivelin Master praktikat mësimore profesionale realizohen në institucionet të ndryshme private ose publike me të cilët universiteti ka marrëveshje.</p>
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	
	<b>X</b>

**Standardi IV.4**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)





**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion u evidentua se FGJH ka bibliotekën e fakultetit, e vendosur në 2 mjedise në katin e dytë, salla “Rozafa” dhe salla ‘Argjiro’, me 80 vende leximi e shfrytëzueshme edhe nga studentët e programeve të studimit në gjuhë frënge. Aksesit në Bibliotekë dhe konsultimi për materialet me punonjësit e Bibliotekës është i lirë, i hapur dhe falas. Orari i shërbimit është i përcaktuar. Konsultimi, komunikimi dhe marrja e dokumenteve apo materialeve është falas. Për programin Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim biblioteka disponon një fond prej 4772 titujsh të cilët përditësohen vazhdimisht. (E: 4.16, 4.17.1)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me literaturë fizike : tekstet mësimore bazë të përcaktuara në syllabuset lëndore të programit të studimit të cilat u vihen në dispozicion të studentëve në formë hard copy ose e-book. Fondi i bibliotekës pasurohet çdo vit me botimet të reja ose/edhe ato të stafit akademik të FGJH. Që prej vitit 2019 e në vazhdim biblioteka e FGJH-së është përditësuar me 357 tituj të rinj, nëpërmjet blerjeve të planifikuara, dhurimeve, artikujve shkencore, tezave të diplomave. (E : 4.17, 4.18, 4.19, 4.22) <i>GVJ sugjeron që hyrjet e reja të jenë më të shumtë në numër për sasi për të siguruar një konsultim më të gjërë për studentët dhe pedagogët.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka vënë në dispozicion biblioteka online të aksesueshme në çdo kohë edhe jashtë mjediseve të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, mjafton vetëm përdorimi i kredencialeve përkatëse, siguruar nga me organizma qeveritarë ose joveritarë si psh.: me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) për abonimin në bibliotekën digjitale JSTOR. Kjo bibliotekë ofron më shumë se 12 milion artikuj të revistave akademike, 85.000 libra dhe 2 milion dokumenta në 75 disiplina. U konstatua edhe aksesit në U-LIBRARY. Biblioteka e FGJH është gjithashtu edhe pjesë e rrjetit të sistemit bibliotekar e informues ”COBISS Por digjitalizimi i bibliotekës është ende në proces. (E: 4.12,4.18).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Në bibliotekën e FGJH janë 2 kompjutera në dispozicion të studentëve me akses në internet dhe burimet <i>online</i> të vendosur në fondet e hapura. Kompjuterat janë të pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. (E : 4.6) <i>GVJ sugjeron shtimin e kompjuterave të tjerë për të mundësuar një konsultim më të gjërë në të njëjtën kohë për një numër më të madh studentësh.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Institucioni i kushton një vëmendje të veçantë pasurimit të fondit të literaturës së bibliotekës përmes planifikimit të një zëri në buxhetin e universitetit në tërësi dhe FGJH në veçanti. Pas konsultimit të dokumenteve, na rezultoi se në buxhetet e viteve 2019-2021, FGJH ka zëra për blerje fond libri, libra, abonime në bibliotekat (burimet) <i>on-line</i> dhe periodikë të nevojshme për këtë program studimi. (E: 4.21, 4.31, 4.32)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka qëndron e hapur e hënë-e premte nga ora 08.00 – 16.30. Zakonisht këto orare janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, duke krijuar në këtë mënyrë kushte optimale për akses tek fondi i saj në çdo kohë që iu nevojitet. Hapësira fizike dhe kapaciteti i saj i jepnin mundësi një numri të konsiderueshëm studentësh për shfrytëzim të ambienteve në të njëjtën kohë, dhe duke pasur mundësi për shfrytëzimin e disa këndeve të saj që të lejonin të punojë në privatësi dhe pa u shpërqëndruar.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)





Shkalla e përmbushjes së standardit	Përcaktimi i rezultateve		X

Standardi IV.5 Institucionit i arsimi të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Sekretaria mësimore është struktura e cila përpilon, administrojnë dhe mban përgjegjësi për mirëmbajtjen e regjistrat themeltar, të hartuar në mënyrë manual. Ajo administrojnë regjistrat themeltarë për këtë program studimi, dosjet personale të studentëve, regjistër bazë të notave, procesverbalet e vlerësimeve të provimeve, regjistrin e diplomave, dokumentacionin e procedurave të transferimit apo çregjistrimit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u evidentuan problemet me Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Studentit, i cili ishte riaktivizuar pas një pezullimi që prej vitit 2017. (E : 4.25).</p> <p>UT/FGJH u ka mundësuar personelit akademik, personelit ndihmës akademik dhe studentëve adresa zyrtare të email-it, [E: 4.25) duke mundësuar edhe aksesin në platformën e integruar Microsoft Teams e unifikuar në nivel universitetidhe perdorur gjërësisht gjatë pandemisë, në mbështetje të zhvillimit e procesit mësimor në distancë dhe komunikimit midis studentëve dhe stafit akademik.</p> <p>Konsultimi i materialeve në aneks evidenton se institucioni në faqen zyrtare elektronike ka të dhëna mbi programet e studimit që ofron, shkollën e doktoraturës, kriteret e pranimit në secilin programë studimi,tarifat e studimit, planet mësimore dhe programet lëndore, orarin mësimor, revistën shkencore, librarinë elektronike, hapsirën e postës elektronike, të dhëna për stafin akademik, projekte në zhvillim, njoftime të ndryshme me tematikë administrative (afate regjistrimi në provime, bursat e studimit, etj.) apo akademike (thirrje të hapura për aplikim për bursa shkëmbimi në kuadër të programeve Erasmus+, Mevlana, etj.) etj.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit që administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit përfaqësohet nga Dega e Burimeve Njerëzore dhe Dega e Protokoll-Arshivës. Gjatë takimit me përfaqësues të këtyre strukturave dhe konsultimit të dosjeve personale te rekrutimit vlerësua mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumentacionit personal të punonjësve dhe të regjistrave themeltar, respektimin e procedurat për rekrutimin e pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm, shpërndarjen dhe grumbullimin e kontratave të punës për të gjithë punonjësit etj</p> <p>I njëjti konstatim vlen edhe për ngarkesat mësimore, semestrare dhe vjetore të anëtarëve të DGJF, planet mësimore kalendarike të hartuara nga pedagogët e DGJF, tezat e provimeve, të miratuara nga përgjegjësi I departamentit. (E: 4.1, 4.2,4.5, 4.5.1).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të informacionit të universitetit është i aksesueshëm nga persona të autorizuar dhe gjithashtu mund të krijohen kushte për akses në informacione e dokumenta për studentët sipas rregullave dhe në zbatim të ligjeve mbi privatësinë dhe ruajtjen e të dhënave personale. Nga sistemi i brendshëm i institucionit mund të aksesohen dokumentacion përkatës për stafin akademik dhe studentët i shprehur edhe në Programin e Transparencës për Universitetin e Tiranës (E: 4.24)</p> <p>Faqja elektronike e FGJH është bashkëkohore, shumë informative dhe lehtësisht e aksesueshme, me informacione të përditësuara mbi bazën ligjore, planet mësimore dhe programeve lëndore, struktura akademike, orarin mësimore, sezonet e provimeve dhe oraret e tyre, fatura të tarifave të studimit, të dhëna për</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)





	stafin akademik, projekte në zhvillim, njoftime të ndryshme me tematikë administrative (afate regjistrimi në provime, bursat e studimit, etj.) dhe akademike (thirrje të hapura për aplikim për bursa shkëmbimi në kuadër të programeve Erasmus+ apo programeve të tjera, etj.).
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni dhe vizita në institucion GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion për komunikimin interaktiv të stafit akademik dhe studentëve platformën "Microsoft Teams" ku zhvillohen diskutime konstruktive nëpërmjet rubrikave të ndryshme që ofron platforma. Studentët mund të shikojnë gjithashtu rezultatet dhe komentet e vlerësimit në mënyrë private. (E : 4.26, 4.26.1) Po ashtu institucioni ruan dhe komunikimin dhe koordinimin midis stafit akademik dhe studentëve si fizikisht ashtu dhe me anë të kontakteve telefonike dhe e-maileve zyrtare të tyre.
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Gjatë vizitës në institucion dhe bisedave me aktorë të ndryshëm (pedagogë, personel administrativ, studentë) u evidentua se sistemi i menaxhimit të brendshëm të FGJH-së undëson raportimin e aktiviteteve në kohë reale nëpërmjet grupeve të komunikimit zyrtar nga adresave zyrtare duke siguruar të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. Gjithashtu nëpërmjet llogarive personale të emailit dhe platformës dixhitale MS Teams, faqeve zyrtare të IAL ( <a href="http://www.unitir.edu.al">www.unitir.edu.al</a> dhe <a href="http://www.FGJH.edu.al">www.FGJH.edu.al</a> ) garantohet në kohë reale monitorimi i aktivitetit akademik dhe administrativ i personelit akademik, ndihmës akademik, raportimet individuale të dhënat mbi organet drejtuese etj.
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Përmes faqes zyrtare por edhe rrjeteve sociale, FGJ jep informacione dhe promovon veprimtaritë e ndryshme me karakter akademik, shkencore, social-kulturor në gjuhën shqipe, angleze, frënge, italiane dhe ruse.
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	
	X

<b>Standardi IV-6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ konstatoi që plani i financimit të programit hartohet duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit të veprimtarive mësimore dhe shkencore i cili miratohet pranë Senatit akademik dhe Bordit të administrimit të UT dhe dorëzohet pranë MAS. Në respect të Urdhrit të Miratimit të Programit të Trasparencës, UT në faqen elektornike të UT, ndër të tjera publikohen informacionet/raportet mbi buxhetin dhe të dhënat financiare. (E : 4.31, 4.32), (E: 4.34).

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)





<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Plani i financimit të programit të studimit përfshin në mënyrë të hollësishme të gjitha detyrimet financiare, pagat, shpenzimet, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës, si edhe aksesin në bibliotekat on-line. (E: 4.28), (E: 4.30, 4.30.1, 4.31, 4.32)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni kryen auditim të brendshëm me anë të Zyrës së Auditit të brendshëm (E: 4.35, 4.37) me qëllim analizën e efektivitetit financiar.</p> <p>. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja harton raportet dhe pasqyrat financiare, të cilat dokumentojnë gjendjen financiare dhe shpërndarjen e burimeve financiare, me të dhëna të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. (E: 4.32, 4.33).</p> <p>GVJ evidenton se një procedurë e tillë i jep mundësi institucionit të ketë një opinion ligjor mbi pasqyrat financiare në lidhje me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kërkuara të kontabilitetit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Në lidhje me raportin financiar për këtë program studimi evidencat tregojnë që institucioni ka burime në dispozicion për financimin e programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p> <p>Raportet dhe analizat përshkruajnë periudhat për vitin në vijim dhe të viteve të kaluara akademike duke bërë që planifikimet dhe ndërhyrjet e posaçme të parashikohen në buxhetet afatmesme për garantimin dhe mbarëvajtjen e të gjitha programeve të studimeve.(E: 4.38, 4.39).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>GVJ në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe vizitës ka konkluduar se raportet financiare të institucionit janë të dokumentuara për të tre vitet e fundit. Raporti financiar i cili përgatitet nga Rektorati dhe miratohet nga Bordi i Administrimit bazohet në planifikimet e kryera në programimin financiar. Sipas këtij raporti, UT ka të ardhura financiare të mjaftueshme për realizimin e objektivave dhe misionit të tij (E: 4.38, 4.39), (E: 4. 31,4.32), (E: 4.33).</p>
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>X</p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p>X</p>
---	----------

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)





## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Referuar RVB-së dhe gjetjeve nga vizita në institucion, GVJ u informua mbi politikën dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje dhe konstatoi se këto politika dhe procedura janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore të institucionit. Në këtë kuadër pranimi i studentëve në cdo vit akademik kryhet në përputhje me kuotat dhe kriteret e miratuara nga cdo program studimi, në të cilat bëhen specifikime dhe zyrtare në faqen e institucionit, procedurën e pranimeve në vitin akademik dhe Udhëzimet që nxjerr MAS. Numri i studentëve si dhe shpërndarja e tyre bëhet sipas zërave në tabelën e përcaktimit të kuotave të pranimit (studentë për program të dytë studimi, transferime, kategori të veçanta). Mësohet gjithashtu se diplomimi i studentëve bëhet në përputhje me rregulloren e programit dhe të diplomimit të FGJH-së dhe se monitorohet hyrja dhe dalja e studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikën dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ vlerësoi faktin se politikën dhe procedurat për pranimin, formimin universitar dhe diplomimin e studentëve garantojnë barazinë dhe të drejta të barabarta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim, të cilat ligjërohen në statusin dhe rregulloren e USH-së, FGJH-së dhe të këtij programi studimi. Ky program studimi krijon kushte të favorshme për respektimin e të drejtave dhe detyrimeve të njëjta për të gjithë studentët që nga momenti kur marrin statusin e studentit deri kur diplomohen, duke siguruar paanësi dhe objektivitet. Kjo u konfirmua edhe nga vizita në institucion gjatë takimit me studentët e këtij programi studimi.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Pas konsultimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion GVJ konstatoi se kriteret, procedurat e pranimit, transferimit, vlerësimit dhe diplomimit përcaktohen në Rregulloren e UT dhe rregulloren e Programit dhe janë të qarta, të kuptueshme dhe aksesueshme për publikun. GVJ vlerësoi gjithashtu faktin se për secilin vit të programit Bachelor në "Gjuhë Frënge" studentët kanë një pedagog kujdestar në rolin e koordinatorit i cili informon mbi organizimin dhe përmbajtjen e planit mësimor dhe ndihmon studentët për çdo parqartësi apo problem. Paraprakisht, DGJF çdo vit organizon takime të hapura me të gjithë maturanët e interesuar të cilët prezantohen me Fakultetin dhe me programin e gjuhës frënge, mjediset e fakultetit, laboratorët ku zhvillohen punët praktike, etj. Një pikë e rëndësishme për të përmbushur këtë kriter janë edhe panairët për promovimin e këtij programi studimi. Këto të dhëna janë të aksesueshme për publikun edhe në faqet zyrtare të USH-së, FGJH-së dhe DGJF-së si edhe në rrjetet sociale të strukturave të lartpërmendura.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Mbështetur në faqen zyrtare dhe në evidencën 5.3 si edhe në takimet në institucion GVJ konstatoi se kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve që pranohen për t'u regjistruar në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Frënge" hartohen nga Departamenti një vit më herët, jo më vonë se fillimi i Dhjetorit, sigurisht duke u bazuar në Urdhrin dhe Udhëzimet e MAS. Bazuar në evidencat përkatëse. GVJ u informua gjithashtu se Senati Akademik miraton dhe publikon në faqen zyrtare të Univeristetit të Tiranës përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve në përputhje me Statutin e Universitetit të Tiranës. Kriteret së bashku me kuotat e përcaktuara nga Departamenti miratohen në Senatin Akademik të UT, përcillen në MAS dhe publikohen në faqen e FGJH e në portalin</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)







	<a href="https://ualbania.al/">https://ualbania.al/</a> e më pas përcillen kuotat e propozuara nga Departamenti i Gjuhës Frënge për vitin akademik pasardhës.		
<b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Pas konsultimit të dokumentacionit dhe evidencave, GVJ mësoi se kuotat përcaktohen mbi bazën e kapaciteteve infrastrukturore dhe personelit akademik e ndihmës-akademik, duke ruajtur standardin e ofrimit të mësimin në kushte normale, sipas përcaktimeve të LAL871 dhe Rregullores së UT-së. Në kuotat e pranimit të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim përpos kandidatëve brenda vendit janë të planifikuara edhe kuota për kandidatë të kategorive: nga diaspora shqiptare; shtetas të huaj; kandidatë me statusin e personit me aftësi të kufizuar; kandidatë me statusin e jetimit; nga komuniteti romë dhe ballkano-egjiptiane; kandidatë që aplikojnë për transferim studimesh; kandidatë që aplikojnë për program të dytë studimi. Për pranimin e studentëve të huaj ndiqet e njëjta procedurë me specifikën që ata duhet të ekuivalentojnë diplomën e shkollës së mesme si dhe të noterizojnë dokumentat shtesë.		
<b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ u informua se përpara fillimit të çdo viti akademik, UT dhe FGJH shpall kalendarin e informimit për nxënësit maturanët dhe sipas këtij kalendari, secili departament organizon aktivitete informuese për maturanët e interesuar, informacione lehtësisht të aksesueshme në faqet zyrtare përkatëse dhe në evidencën e pasqyruar në RVB. Në kuadër të këtyre aktivitetëve, DGJF organizon takime të hapura me të gjithë maturanët e interesuar të cilët prezantohen me programin e studimit Bachelor në Gjuhë frënge, kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit, mjediset e fakultetit, labororet ku zhvillohen punët praktike, etj. Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua gjithashtu se përgjegjësi i Departamentit sipas orarit të publikuar në rrjetet sociale të Departamentit të DGJF organizon në ditën e parë të vitit akademik një takim me të gjithë studentët dhe personelin akademik që angazhohet me mësimdhënie në këtë program studimi dhe studentëve u prezantohen lëndët e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim dhe lektorët e tyre, kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit si edhe me pedagogun kujdestar me të cilin duhet të kontaktojnë për çdo paqartësi apo problem.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>			X

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	U evidentua se informimi dhe një përshkrimi i përgjithshëm i këtij programi studimi mbi lëndët që përmban, kreditet për secilën lëndë, detyrimet dhe format e shlyerjes, mënyrat e kontrollit të dijes, nëpërmjet faqes zyrtare elektronike të DGJF-së, e cila është e aksesueshme për gjithë të interesuarit. Informacion më të plotë rreth Departamentit të Gjuhës Frënge dhe Programit të studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim me profilet përkatëse që ai ofron, kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, studenti e merr edhe përmes guidës së fakultetit, pjesë e së cilit është edhe DGJF, si edhe nga departamenti në bashkëpunim me strukturat e tjera mbështetëse të institucionit. Konkretisht, në orën e parë të mësimin, pedagogu i lëndës prezanton studentët me programin mësimor (Syllabusin) literaturën bazë dhe ndihmëse të lëndës, mënyrën e vlerësimin, detyrimet e studentit, frekuentimin dhe çdo

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)







	informacion tjetër për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Studentët informohen edhe me anë të adresave të tyre elektronike nga secili pedagog mbi orarin mësimor, njoftime mbi aktivitete, ëorkshope apo konferencat, oraret e pritjes nga pedagogët, informimi për syllabuset etj. Nuk mungojnë edhe afishimet me postera apo me njoftime të ndryshme. Gjatë vizitës në institucion, në takimin me studentët, GVJ u informua nga përfaqësuesja e këshillit studentor se studentët informohen në lidhje me problematikat e tyre me anë të gjitha këtre mekanizmave që rezultojnë të jenë shumë eficientë.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Pas konsultimit të RVB –së dhe gjatë vizitës në institucion në takimin me studentët, GVJ mësoi për punën që bëhet në informimin e studentëve lidhur me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Në këtë kuadër, u kostatua se çdo student, duke përfshirë edhe studentët e huaj, informohet rregullisht për procedurat dhe afatet e njohjes së diplomës së studimeve të mëparshme. Gjithashtu një rol të rëndësishëm luan edhe sekretaria mësimore e cila informon studentët mbi kriteret e procedurat e njohjes të kualifikimeve të mëparshme, bazuar në statutin e Universitetit të Tiranës dhe rregullores së transferimeve parashikuar në aktet e brendshme rregullatore.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Nga gjetjet në RVB (sipas evidencave përkatëse në lidhje me rregulloret e USH-së, FGJH-së dhe DPF-së) dhe informacionet nga vizita në institucion, GVJ konstatoi që studentët informohen rregullisht në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim. Studentët konfirmuan se ata informohen orën e parë të çdo lënde për peshën e secilit komponent vlerësimi. Në Syllabuset e këtij programi studimi është përfshirë edhe vlerësimi i studentit. Studentët pohuan se vlerësohen me pikë përmes një kombinimi të frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimit në auditor, provimeve me shkrim, eseve/detyrave të kursit, etj, dhe se ata kanë të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korrigjimit, me pikët totale të vlerësimit si dhe me pikët në çdo rubrikë.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Bazuar në evidencat përkatëse mbi rregulloren e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim dhe gjatë takimit me përgjegjësen e departamentit dhe pedagogun kujdestar të vitit të tretë të studimeve u evidentua se studentët janë të mjaftë informuar se provimi i diplomimit, sipas profileve përkatëse zhvillohet në formë eseje, për të cilën janë zhvilluar takime orientuese për mënyrën e hartimit dhe vlerësimit të esesë.
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Për të gjithë ata maturantë që duan të aplikojnë për një program studimi në USH, është faja zyrtare përmes së cilës ata informohen për çdo program studimi. Gjithsesi, mbështetur në evidencat e pasqyruara në RVB dhe në takimin me specialisten e Zyrës së Karrierës dhe Këshillimit, u konstata se bëhet një punë shumë e mirë për informimin e saktë dhe të detajuar për këtë program studimi, me anë të takimeve të hapura në mjediset e fakultetit, fletëpalosjeve dhe guidës së hartuar për një orientim sa më të volitshëm të studentëve të ardhshëm. Për promovimin e programeve të studimit, FGJH organizon gjithashtu edhe pjesëmarrje në panairë të ndryshme studimore që kanë si qëllim informimin e maturantëve lidhur me studimet që mund të kryejnë.
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>X</b>

<b>Standardi V.3</b>	
Institucioni i arsimit të lartë ve në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)





<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>GVJ evidentoi faktin se informimi i studentëve për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim bëhet fillimisht gjatë axhendave të takimeve informuese në FGJH apo edhe në panairë të ndryshme dhe nëpërmjet broshurave informative dhe informacionit të programit të studimit të ofruar në faqen zyrtare të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe në faqen zyrtare të Departamentit të Gjuhës Frënge. Gjatë vizitës në institucion, konkretisht në takimim me studentët, GVJ u informua se ata marrin informacione të vazhdueshme nga pedagogu/ët i lëndës, përmes syllabuseve të lëndëve që zhvillohen si edhe nga sekretaria mësimore, mbi vlerësimet e zhvilluara gjatë semestrit, si: vlerësimi i provimit të ndërmjetëm, vlerësimi i aktivizimit në seminare, detyra kursi dhe vlerësimi përfundimtar.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Përpos evidencave të pasqyruara në RVB, GVJ u informua nga studentët se çdo pedagog në fillim të lëndës/modulit i informon studentët me përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese duke u bazuar në syllabusin e lëndës/modulit. Për informimin e studentëve të vitit të parë, DGJF sipas orarit të shpallur në faqen zyrtare dhe rrjetet sociale të FGJH-së, organizon takime të hapura me të gjithë studentët e vitit të parë për t'i prezantuar ata me programin e studimit, personelin akademik që angazhohet me mësimdhënie në këtë program studimi, strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, deri tek njohja me rregulloren e programit të studimit. Në këtë mënyrë, studentët janë të mirëinformuar për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit (informacion i siguruar në RVB), GVJ mësoi se për të informuar studentët rreth tregut të punës si dhe për t'i njohur ata me mundësitë e punësimit, trajnimeve, praktikave të punës dhe internshipeve të ndryshme, UT, pjesë e të cilit është edhe FGJH dhe DGJF, organizon çdo vit Panairin e Karrierës, ku studentët kanë mundësi kontaktimi edhe me subjekte publike dhe kompani private të cilat marrin pjesë në panair, duke u ofruar mundësi punësimi në institucione apo biznese të ndryshme private. GVJ vlerësoi faktin se UT ka realizuar aktivitetin "Java e Europës në UT", me qëllim informimin dhe përfshijën e studentëve në periudha shkëmbimi në univesitetet partnere të BE, duke ndihmuar formimin e tyre dhe aftësimin më tej në tregun e punës. Për sa më sipër, edhe specialistja praçë Zyrës së Këshillimit të Karrierës pohoi se informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe organizon trajnime për studentët për të realizuar një aplikim pune të suksesshëm.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, u evidentua që studentët e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim e marrin informacionin mbi zhvillimin e procesit mësimor të plotë dhe të përditësuar. Në hyrje të mjediseve të FGJH-së por edhe përgjatë kateve ku ndodhen departamentet dhe auditoret, gjendet stenda dhe ekranet e informimit të studentëve ku ata njihen me orarin mësimor dhe njoftimeve të ndryshme që kanë të bëjnë me procesin mësimor apo aktiviteteve të ndryshme që zhvillon DGJF. Në takimim me studentët, studentët demonstuan njohje të plotë të informacionit mbi procesin mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet.</p>
<p><b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>GVJ konstatoi se të gjitha strukturat në funksion të realizimit të programit të studimit, duke filluar që nga strukturat drejtuese dhe personeli akademik i Departamentit të Gjuhës Frënge, personeli ndihmës-akademik i departamentit, sekretaria mësimore, zyra e informacionit, Zyra e Këshillimit të Karrierës, me studentët ndjekin politikën e "dyerve të hapura" dhe në çdo rast janë të disponueshëm të lehtësojnë jetën e tyre studentore. Ky informacion jepet gjithashtu edhe online në ëbesite të fakultetit si dhe në adresat zyrtare të e-mailit të UT-së. Në kushtet e pandemisë, studentët kanë komunikuar me anë të sistemit TEAMS.</p>
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>X</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)





Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administro, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Gjatë konsultimit me RVB dhe vizitës në institucion, GVJ mësoi se FGJH/DGJF disponon statistika mbi numrin e të diplomuarve në programin e studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim, statistika që mbahen në sekretarinë mësimore, në regjistrin themeltar të studentëve të këtij programi dhe janë pjesë e analizave dhe raportimeve vjetore. Kështu, për vitin akademik 2018-2019 janë diplomuar 93 studentë në këtë program studimi; për vitin akademik 2019-2020 janë diplomuar 90 studentë; për vitin akademik 2020-2021 janë diplomuar 79 studentë në këtë program. Të gjitha këto të dhëna regjistrohen në sekretarinë mësimore në: regjistrin themeltar të studentëve; regjistrin e arritjeve akademike të studentit; regjistrin e lëshimit të diplomave, etj. Gjithashtu, sekretaria mësimore regjistron dhe ruan të dhëna për: procesverbalet e provimeve; studentët që ndjekin programe të dyta të studimit; frekuentimin e studentëve; numrin e studentëve që e humbasin statusin e studentit; numrin e studentëve që çregjistrohen. Kjo u konfirmua nga sekretarja mësimore e ngarkuar për programin e studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim edhe gjatë vizitës në sekretarinë mësimore.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Gjatë takimit me përfaqësues të Sekretarisë Mësimore GVJ vëzhgoi të dhënat për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. GVJ u informua gjithashtu se në FGJH arkiva themelore përbëhet nga dokumentacioni i plotë i dosjeve me të dhënat e studentëve që nga momenti i pranimit e deri tek momenti i diplomimit, i cili ruhet në formë të printuar, elektronike ose edhe në regjistrat e plotësuar manualisht në zyrën e sekretarisë mësimore. Gjatë takimit me sekretaren mësimore, GVJ mësoi se Sekretaria mësimore e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja disponon të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar, largimet para përfundimit të programit dhe mospërfundimin me sukses të vitit akademik. Këto të dhëna gjenden në database të sekretarisë mësimore dhe në formën hard-copy. Konkretisht, rezultojnë që gjatë tri viteve akademike të jenë regjistruar 135 studentë.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Gjatë takimit me përfaqësues të Sekretarisë Mësimore GVJ mësoi se të dhënat për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. FGJH/DGJF disponon statistika mbi ecurinë e studentëve të këtij programi, që nga pranimi deri në diplomim. Këto të dhëna bëhen pjesë e raporteve të ndryshme që hartohen si në nivel njësie bazë ashtu edhe në raportin vjetor institucional, si dhe janë pjesë e raportimeve institucionale. U evidentua se këto statistika mbahen në sekretarinë mësimore, në regjistrin e studentëve të këtij programi dhe janë pjesë e analizave dhe raportimeve vjetore.
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	GVJ konstatoi se të dhënat ruhen dhe menaxhohen në formën e regjistrave "hard copy". Të dhënat janë reflektim/pasqyrim i rezultateve të procesverbale të provimeve që sekretaria mësimore përpilon dhe ua vë në dispozicion pedagogut të lëndës për t'i plotësuar dhe dorëzuar sërish të firmosur nga të dy antëtarët e komisionit. Këto të dhëna janë të sigurta dhe të verifikueshme nga personat e autorizuar. Sekretaria mësimore përpilon edhe regjistra specifikë për çdo lëndë, si dokument zyrtar që evidenton dhe vërteton zhvillimin e orës së mësimi nga pedagogu dhe frekuentimin e orës së mësimi nga studenti. Gjithashtu, çdo pedagog mban regjistrin e tij të lëndës si dokument që evidenton dhe vërteton zhvillimin e orës së mësimi nga ai dhe frekuentimin e orës së mësimi nga çdo student. Është implementuar edhe sistemi <i>E-student</i> i cili bën të mundur plotësimin e të

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.asc.al](http://www.asc.al)

E-mail: [info@asc.al](mailto:info@asc.al)





	dhënave online nga ana e pedagogëve dhe sekretaria mësimore dhe aksesit i të dhënave në kohë reale edhe nga studentët. Gjatë vizitës në ambientet e sekretarisë mësuam se sistemi e-student, i cili menaxhohet nga Rektorati i UT-së, ishte në proces përmirësimi. Rekomandim: Të funksionojë rregullisht.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Mbështetur në evidencën 5.23 dhe në analizën e detajuar në lidhje me tri profilet e këtij programi studimi të pasqyruar në RVB mësojmë se Zyra e Karrierës/Alumnit, e cila është struktura përgjegjëse që mban kontakte me të diplomuarit dhe kontakton në mënyrë të herëpashershme me ta, ndjek në vazhdimësi edhe të diplomuarit duke u informuar për karrierën e tyre dhe ndikimin që kanë patur ky program studimi në karrierën e tyre. U evidentua se këto të dhëna ndikojnë në marrjen e masave sa më efektive për të rritur cilësinë e të diplomuarve nga ky universitet.
	X

<b>Standardi V.5</b> Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	U konstatua se UT ka realizuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve përkatësisht përfaqësuesve të tyre, në organet vendimmarrëse e këshilluese. Konkretisht në këtë institucion funksionon Këshilli i Studentëve. Këshillat e studentëve janë organizime të pavarura të studentëve të UT-së, të cilët përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e studentëve të UT-së në të gjitha programet e studimit. Këshillat e studentëve kanë mandat 2-vjeçar dhe anëtarët e tyre zgjidhen nga votat e të gjithë studentëve të UT-së ose njësisë kryesore. Rregullat në lidhje me procesin e votimit përcaktohen qartë në rregulloren e zgjedhjeve për këshillat e studentëve të UT-së (informacion i aksesueshëm në faqen zyrtare të UT-së ( <a href="https://unitir.edu.al/komisioni-institucional-zgjedhor-studentor/">https://unitir.edu.al/komisioni-institucional-zgjedhor-studentor/</a> )). Të drejtat dhe detyrimet e të cilit bazohen në Legjislacionin Shqiptar si dhe në statusin, rregullat dhe rregulloret e UT-së. Përfshirja e studentëve është parashikuar në një sërë strukturash vendimmarrëse kolegjinale si: - Senati Akademik - Komisioni i Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët - Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë - Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës - Këshilli i Etikës dhe në Këshillat e studentëve.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Siç u theksua edhe në kriterin e mësipërm, UT ka realizuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve përkatësisht përfaqësuesve të tyre, në organet vendimmarrëse e këshilluese. Përmes anëtarësimit të përfaqësuesve të studentëve të zgjedhur në Senati Akademik, Komisionin e Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët, Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës, Këshillin e Etikës dhe në Këshillat e studentëve, si dhe pjesëmarrjen aktive të këtyre përfaqësuesve studentë në mbledhjet e këtyre organeve, sigurohemi që përfshirja e përfaqësuesve të studentëve në vendimmarrje dhe çështje që i

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.asc.al](http://www.asc.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)






	përkasin procesit akademik është efektive dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme dhe të matshme. Kjo u konfirmua edhe nga një studente, përfaqësuese e Këshillit studentor.		
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Përsa i përket përmbushjes së këtij kriteri GVJ konstatoi se institucioni e merr parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit kryesisht gjatë hartimit dhe përmirësimit të programit të studimit si kurrikulë dhe si syllabuse, mbështetur në ligjet dhe aktet nënligjore të institucionit dhe në përputhje me ligjin “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, etj. Shpërndarja e lëndëve nëpër semestra dhe ngarkesa e shprehur në kredite bëhet mbi parimin e një shpërndarje të balancuar në semestra. Në statutin e institucionit dhe në aktet e tij rregullatore të brendshme parashikohen kriteret dhe procedura që lehtësojnë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme të realizuara nga studenti.		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Përsa i përket përmbushjes së këtij kriteri, GVJ u evidentua se garantohej përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit në USH nëpërmjet organizimit të tyre në Këshillin e Studentëve dhe përfaqësuesve në organet e rëndësishme të lartpërmendura. Kjo përfshirje, siç doli edhe nga takimi me përfaqësues të tyre, ka ndikuar pozitivisht në strukturimin e kurrikulës dhe syllabuseve të lëndëve.		
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Gjatë takimit me studentët ata u shprehën se mund të japin mendime mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve si dhe mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit të tij dhe reflektimit nga ana e institucionit përkatësisht njësisë dhe pedagogut përgjegjës.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

#### Standardi V.6



**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Mbështetur në evidencat përkatëse dhe në takimin me specialisten e Këshillimit të Karrierës Fakulteti i Gjuhëve të Huaja dhe specialisten e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës ofron shërbimin e informimit të studentëve nëpërmjet Specialistes së Këshillimit të Karrierës dhe zyrës së informacionit. Veprimtaria e Specialistes së Këshillimit të Karrierës është në përputhje me statutin e universitetit. (E: 5.28). UT dhe çdo njësi kryesore/bazë e tij publikon vazhdimisht në faqen elektronike dhe ‘hard copy’ udhërrëfyes dhe broshura informuese për studentët. (E:5.9). Departamenti i Gjuhës Frënge në bashkëpunim me njësi/struktura të tjera si sekretaria mësimore, pedagogët kujdestarë, dega e IT, personeli i financës për shërbimet e bursave, etj., informon studentët mbi programin e studimit, përmbajtjen dhe organizimin e tij, kohëzgjatjen e studimeve në këtë program dhe afatin e përfundimit, akreditimin dhe mundësitë për punësim pas diplomimit, kalendarin akademik, fillimin dhe mbarimin e vitit akademik, pushimet/festat zyrtare, sezonet e provimeve etj. Gjatë periudhës së pandemisë studentët janë informuar dhe kanë patur mundësi të vihen në kontakt të drejtpërdrejtë me pedagogët kujdestarë ose/dhe të lëndës nëpërmjet

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)




	<p>platformës online në MS Teams të ofruar nga UT. Studentët informohen gjithashtu edhe me anë të faqes elektronike të UT/FGJH dhe DGJF-së.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Në faqen zyrtare të UT-së (<a href="https://unitir.edu.al/marredheniet-me-studentet-dhe-karriera/">https://unitir.edu.al/marredheniet-me-studentet-dhe-karriera/</a> GVJ mësoi se Drejtorja e marrëdhënieve me studentët dhe marrëdhënieve me publikun publikon informacionet e nevojshme me anë të guidave, rregulloreve, fletëpalosjeve, procedurave etj, të cilat u vihen në dispozicion studentëve. FGJH dhe departamenti përditëson dhe publikon materiale dhe broshura informative, të cilat përmbajnë informacione të rëndësishme për programin e studimit, infrastrukturën, personelin akademik, jetën studentore, dhe mjaft informacione të vlefshme për studentët dhe përfshirjen e tyre në fakultet. (E: 5.9). GVJ vlerësoi edhe gatishmërinë e stafit akademik për të ofruar asistencë të vazhdueshme për çështje që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit në dispozicion të studentëve edhe orë takimi në zyrë (E: 5.39).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>U evidentua se në UT e konkretisht në FGJH Zyra e Këshillimit të Karrierës ofron në mënyrë të vazhdueshme këshillim karriere, informacion mbi vende pune, informacion mbi praktikën profesionale (kur e përmban programi i studimit), informacion në lidhje me trajnime dhe ëorkshope, mundësi punësimi. Specialistja e Këshillimit të Karrierës është në dispozicion të studentëve nga dita e hënë deri të premte, ne orarin 8.00– 16:30. Studentëve u ofrohet gjithashtu ndihmë për të përgatitur një CV, letër motivuese, intervistë, etj., dhe aftësi për t’u prezantuar denjësisht me punëdhënësin e parë. Gjithashtu, janë organizuar panaiere pune ku studentët kanë mundësi të vihen në kontakt të drejtëpërdrejtë me subjekte publike dhe kompani private që informojnë studentët me kërkesat e tregut të punës dhe u ofrojnë pozicionet vakante. GVJ vlerësoi edhe trajnimet jashtë shteti të stafit akademik dhe studentëve në kuadër të marrëveshjeve Erasmus+, KA107, Mevlana, etj, me qëllim që ata të mund të shkëmbejnë eksperiencë se si të integrohen në tregun e punës.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Edhe përsa i përket përmbushjen së këtij kriteri, GVJ mësoi se një rol parësor luan Zyra e Këshillimit të Karrierës e cila ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon dhe ruan të dhënat mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim. Këto të dhëna ua vë në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse. Pas diplomimit Specialistja e Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore kontakton me studentët e diplomuar nëpërmjet email-it, numrit të telefonit dhe rrjeteve sociale dhe harton relacione për punësimin e studentëve.</p>
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	
	X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	
	X

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)





## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në përputhje me Legjislacionin e Arsimit të Lartë, në nivel institucional ushtron veprimtarinë e tij Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë. Në nivel njësie kryesore, dhe respektivisht edhe në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja bazuar në Statutin e Univeritetit të Tiranës funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) (referuar E: 1.1, Evidencave 6.2, 6.3 dhe 6.4, u evidentua se UT ka hartuar një politikë të qartë të sigurimit të brendshëm të cilësisë shprehur në dokumente rregullatore si Rregullorja për sigurimin e cilësisë në Universitetin e Tiranës, Manuali i cilësisë, Rregullorja për vlerësimin e performancës së personelit ndihmesakademik dhe administrativ në UT dhe Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik i UT-së. Gjithashtu realizohen edhe studime gjurmuese për të vlerësuar efikasitetin dhe cilësinë e programeve të ofruara nga fakulteti.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, me nën-njësitë e tij, struktura të përcaktuara në statusin e UT-së, përbëjnë sistemin e brendshëm të Sigurimit të Cilësisë të UT-së. Konkretisht, referuar evidencave 6.9, 5.23 dhe 5, GVJ vlerësoi faktin se FGJH ka përcaktuar persona përgjegjës nga çdo departament i Fakultetit, të cilët koordinojnë procesin e sigurimit të cilësisë në Fakultet dhe bashkëpunojnë punën me Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë në nivel instucional me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë së aktiviteteve të tij dhe komponentëve ndihmës si: stafi akademik, administrative dhe ndihmës, studentët. Meqenëse sipas statusit të UT-së, mundësia e një eksperti të jashtëm është fakultative, njësia nuk e ka një të tillë (E: 1.1).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Referuar evidencave 6.12, 6.13, 6.14, 6.15 dhe 6.16, GVJ konstatoi se FGJH ka krijuar mekanizmat e nevojshme matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimit, përmes takimeve, sondazheve dhe anketimeve me studentët. NJSBC ka përgatitur pyetësorë sipas tematikave të cilat janë shpërndarë tek studentët për t'u plotësuar në mënyrë anonime. Pas analizimit të të dhënave është finalizuar procesi me komunikimin e rezultateve të pyetësorëve. GVJ vlerësoi faktin se në nivel fakulteti kryhet vlerësimi i performancës së personelit akademik në lidhje me ofrimin cilësor të programit të studimit, jo vetëm në aspektin mësimdhënës, por edhe në aspektin e kërkimit shkencor, kontributit për institucionin. Përgjegjësit e departamenteve në përfundim të vitit akademik plotësojnë performancën e stafit akademik përkatës. Gjithashtu bëhet edhe vlerësimi i aktivitetit shkencor i stafit pedagogjik nëpërmjet evidentimit të artikujve të botuar dhe prezantimeve në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu përgjegjësit e departamenteve vlerësojnë edhe aktivitetin administrativ të pedagogëve, korrektesën në kryerjen e tyre, realizimin e shërbimeve ndaj studentëve, respektimin e afateve kohore të këtyre aktiviteteve. Në përfundim të këtij procesi, hartohen raportet /analizat dhe të dhënat e dala nga procese vlerësimi përfshihen në raportet vjetore në nivel departamenti/fakulteti duke evidentuar problematika sipas aspekteve dhe adresuar ato për zgjidhje, proces ky i vazhdueshëm lidhur me përmirësimin e cilësisë. Rekomandim: Të sensibilizohen studentët për një përfshirje më të gjerë në plotësimin e pyetësorëve.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një</p>	<p>GVJ vlerësoi faktin se UT, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.asc.al](http://www.asc.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)





politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	të Cilësisë në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në njësitë kryesore kanë përgatitur dhe zbatojnë politikën e vlerësimit të cilësisë parashikuar në Rregulloren për sigurimin e cilësisë në Universitetin e Tiranës, në Manualin e cilësisë, në rregulloren për vlerësimin e performancës së personelit ndihmesakademik dhe administrativ në UT, në Manualin e vlerësimit të performancës së personelit akademik i UT-së dhe rregulloren e NJSBC në nivel fakulteti, në të cilat mund të konsultohen modalitetet e monitorimit të cilësisë dhe periodiciteti i zbatueshmërisë së tyre.
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>X</b>

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	Referuar faqes zyrtare të UT-së si dhe evidencave përkatëse, GVJ mësoi se si strukturë e posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit në nivel institucional, janë Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës. Për të siguruar dhe garantuar sigurimin e cilësisë së programeve të studimit të ciklit të parë në nivel Njësie Kryesore është ngritur Njësia e Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë dhe Kurrikulës (NJSBCK). përgjegjësit e departamenteve komunikojnë me zëvendësdekanin e Ciklit të Parë të Programit të Studimit dhe zëvendësdekanin për kërkimin shkencor, të cilët koordinojnë dhe planifikojnë raportimet e punës mësimore dhe kërkimore, duke pasqyruar edhe ndryshimet në funksion të përmirësimit të përmbajtjes dhe cilësisë së programeve të studimit.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Mbështetur në evidencat e ofruara në RVB dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se hartohen raporte vjetore në nivel universiteti, fakulteti dhe departamenti, në të cilat përmbledhen analiza e procesit mësimor me të gjithë komponentët e tij si dhe raporti i analizës së kërkimit me të gjithë komponentët e vlerësimit të tij. Në DGJF procedurat për ndryshime në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Frënge" janë bërë në përputhje me bazën ligjore (Ligji Arsimit të Lartë, VKM, Urdhra, Udhëzime nga MAS). Ndryshimet kanë ndjekur procedura standarde.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Referuar evidencave dhe gjatë vizitës në institucion u evidentua se vlerësimi i ecurisë dhe mbarëvajtjes së programit të studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim realizohet çdo vit me anë të pyetësorëve studentorë (në formatin "hard-copy" fizikisht në klasa si edhe online) për cilësinë e mësimdhënies të realizuar për lëndët e këtij programi studimi në fund të çdo semestri dhe para sezonit të provimeve. NJSBC ka realizuar gjithashtu edhe pyetësorin "Vlerësimi nga personeli akademik". Pas realizimit të pyetësorëve NJSBCK harton raporte lidhur me rezultatet dhe analizat e tyre të cilat më pas përcillen në Dekanat dhe pranë çdo njësie bazë. Hartohet gjithashtu një plan masash me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore.
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	GVJ mësoi se rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen në formë raportesh të cilat u përcillen autoriteteve vendimmarrëse për programin e studimit, përgjegjësit të departamentit dhe dekanit, sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Të gjitha rezultatet përfshihen në analizat vjetore të njësive bazë dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)







	kryesore të FGJH-së.
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	GVJ vlerësoi faktin se raportet e vlerësimit të cilësisë, të lartpërmendura në kriteret 1-4, përfshijnë rezultatet e marra si dhe masat në formë rekomandimesh dhe sugjerimesh për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së programeve.
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	
	X

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe sigurimin e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	GVJ mësoi se Departamenti është njësi bazë që bën vlerësimin sistematik të programit të studimit. DGJF e përdor këtë dokumentacion në kuadër të akreditimeve apo edhe të vlerësimeve të brendshme periodike, të dhënat përdoren në dokumenta të procesit të vetëvlerësimit duke hartuar një plan masash. Rishikimi periodik i programit dhe përditësimi i tij me elemente të reja realizohet në bashkëpunim me NJSBC dhe në përputhje me procedurat, aktet rregullatore të FGJH-së dhe planit strategjik të NJSBC.
<b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	GVJ mësoi gjithashtu se reagimet apo sugjerimet e stafit akademik dhe të studentëve dhe raportet e organeve akredituese përdoren kryesisht si instrumente për përmirësimin e mëtejshëm të programeve të studimit. Përveç instrumenteve të lartpërmendura, vlen të përmenden edhe sondazhe dhe intervista të studentëve në lidhje me përmirësimin e kurrikulës (referuar paketës së instrumenteve të sigurimit të cilësisë).
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Referuar gjetjeve në RVB, u konfirmua se FGJH dhe Njësitë përdorin metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. <ul style="list-style-type: none"> <li>• Çdo vit akademik hartohen raportet vjetore ku pasqyrohet veprimtaria institucionale duke realizuar një analizë të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor me të gjithë komponentët dhe elementët e tij</li> <li>• Çdo vit akademik realizohen ndryshimet në masën 20% të planeve mësimore .</li> <li>• NJSBC realizon pyetësorët e përvitshëm dhe harton analizat përkatëse.</li> <li>• NJSBC harton raportet vjetore mbi vlerësimin e cilësisë dhe i bën ato publike.</li> <li>• Njësitë Bazë në bashkëpunim me Përgjegjësit e Departamenteve mbikqyrin dhe monitorojnë respektimin e programeve të mësimdhënies, kërkimeve shkencore dhe veprimtarive të tjera, ndjekin aktivitetin mësimor dhe shkencor të stafit akademik dhe ndihmës-akademik dhe vëzhgojnë studentët gjatë zhvillimit të seanceve laboratorike, detyrave të ndryshme apo testimeve gjatë vitit akademik;</li> <li>• Performanca e stafit akademik</li> </ul>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara	Referuar paketës së instrumenteve e cila është edhe e aksesueshme edhe në faqe elektronike, FGJH/DGJF përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi. GVJ vlerësoi faktin që gjatë sezonit të diplomimit në muajin korrik studentët e diplomuar në programin e studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim japin

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)





<p>(alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>vlerësimin dhe mendimin e tyre kritik për cilësinë e programeve të studimit nëpërmjet plotësimit të pyetësorit “Vlerësimi i studentëve që diplomohen” dhe “Raporti i studentit”.</p> <p>Në vitin 2021 FGJH realizoi një studim tregu aktual duke gjurmuar studentët dhe duke realizuar pyetësorë në bazë të tre profileve të studimeve të kryera. Në shërbim të përmirësimit të cilësisë, realizohet pyetësori “Raport i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu” ku secili anëtar i personelit akademik bën një vetëvlerësim/analizë të lëndëve ku janë titullarë bazuar në përqindjen e kalueshmërisë të studentëve dhe shpendarjes së notave në përqindje. Personeli akademik jep më tej mendimin e tij kritik për lëndët dhe ndryshimet në përputhje me standardet dhe kërkesat e ASCAL. Për vitin akademik 2020-2021 është realizuar “Raporti i vetëvlerësimit nga pedagogu”.</p>
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p style="text-align: right;">X</p>

<p><b>Standardi VI.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i strukturës dhe dokumentacionit të Sistemit e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, GVJ konstatoi se UT ka ngritur mekanizmat e mjaftueshëm me përfaqësues anëtarësh të brendshëm dhe të jashtëm. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC) është përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. U evidentua se Institucioni gjithashtu ngre grupe pune për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe ofron asistencën dhe bashkëpunimin institucional sa herë që në kuadër të sigurimit të jashtëm të cilësisë Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë bazuar në Ligji 80/2015 neni 104, pika 5, realizon Sondazhin Kombëtar të Studentëve, duke treguar frymën e bashkëpunimit si me aktorët e brendshëm edhe me aktorët e jashtëm që ndikojnë në përmirësimin e vazhduar të cilësisë.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në statutin e UT-së, si dhe në rregulloret e tjera, institucioni përcakton përgjegjësitë dhe detyrat specifike të njësive kryesore, individëve, studentëve dhe palëve të tjera të përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë (Referuar të dhënave tabelore mbi NJSBC-në). GVJ vlerësoi angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse i cili lidhet direkt me sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Konkretisht, studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Komisionin epërhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë me 3 anëtarë (në përputhje me nenin 41, Statuti i UT), në Komisionin e përhershëm të kurrikulës. Studentët angazhohen gjithashtu në vlerësimin e programeve akademike si dhe në vlerësimin institucional si pjesë e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Departamenti, si njësi bazë, është përgjegjëse për mirëfunksionimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë së programeve përkatëse të studimit. GVJ konstatoi se Përgjegjësi i programit të studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim, Personeli akademik e administrativ, si dhe studentët e programit të studimit janë të përfshirë në vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë. GVJ vlerësoi faktin që studentët janë të përfshirë në procesin/sistemin e sigurimit të cilësisë së programit mësimor nëpërmjet anketimeve periodike nga NJSBC, marrjes së mendimeve dhe propozimeve nga Këshilli Studentor, takimeve me Kujdestarët e programit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset</p>	<p>Senati Akademik i Universitetit është struktura që vlerëson, garanton dhe është përgjegjës për sigurimin e cilësisë në institucion, në përputhje me integritetin</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)





ciklike të vlerësimit duhet të respektojnë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	akademik duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike. Referuar rregullores së NJSBC-së dhe rregullores për sigurimin e cilësisë në UT, vlerësimi i cilësisë së programit të studimit realizohet edhe nga studentët e çdo kursi në mënyrë anonime duke ruajtur konfidencialitetin e tyre.
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Referuar evidencave 1.11 dhe 1.12, GVJ mësoi se në kuadër të bashkëpunimeve me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, ose edhe me ekspertë të organizmave të ndryshëm qeveritarë dhe joqeveritarë, në mënyrë të vazhdueshme realizohen shkëmbime përvojash dhe vlerësimesh nëpërmjet forumeve të ndryshme të diskutimit rreth cilësisë së programit dhe përmirësimin e saj.
<b>Shkalla e përmbashjes së standardit</b>	
	<b>X</b>

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, UT/FGJH i bën transparente dhe publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit, politikën, strategjinë, organizimin dhe veprimtaritë për të gjitha programet e studimit me anë të linkut në faqen zyrtare të UT-së ( <a href="https://unitir.edu.al/programi-i-transparences-2">https://unitir.edu.al/programi-i-transparences-2</a> ), analizën e pyetësorëve, Statutin, Rregulloren, Vendimet e Senatit Akademik, Vendimet e Bordit të Administrimit, aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë, etj. si dhe nëpërmjet shkresave zyrtare të gjitha njësitë bazë duke krijuar kështu një institucion të hapur për të gjithë aktorët e brendshëm e të jashtëm të tij. Gjatë vizitës në institucion jo vetëm nga dekanja e FGJH-së dhe përgjegjësjë e DDGJF-së, por edhe nga vetë studentët u konfirmua se ata merrnin informacione të hollësishme në faqen zyrtare të institucionit. Studentët konfirmuan se ndjeheshin vërtet të kënaqur me mësimdhënien, komunikimin transparent të stafit akademik dhe atij ndihmës.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Në kuadër të vlerësimit të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim, GVJ mësoi se rezultatet e këtij vlerësimi, të cilat publikohen në hard copy ose në mënyrë elektronike, janë të dala nga vlerësimi i programit të studimit në analizën e departamentit, fakultetit dhe nga pyetësoret dhe anketimet që zhvillohen me studentët nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Rezultatet e vlerësimeve periodike diskutohen gjithashtu edhe në takime informuese dhe dëgjësat që zhvillohen me studentët. Informacioni i publikuar në raporte respekton lirinë dhe etikën akademike sipas legjislacionit në fuqi.
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Mbështetur në evidencën 6.21, GVJ mësoi se në raportet analitike në nivel departamenti, diskutohet plani i masave me qëllim përmirësimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara. Gjithashtu raportet e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë japin rekomandime, të cilat i paraqiten dekanatit për të ndërmarrë hapa konkretë dhe plane veprimi për trajtimin e problemeve të evidentuara.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së	Referuar rregullores të UT-së, FGJH-së dhe DGJF-së, si edhe evidencave 1.11 dhe 1.12, u evidentua se politikat dhe procedurat e sigurimit të cilësisë janë zyrtarisht të miratuara, të dokumentuara dhe janë rishikuar e zhvilluar si përgjigje ndaj ndryshimeve kombëtare dhe ndërkombëtare me synim përmirësimin e

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




programit të studimit.	vazhdueshëm.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	U evidentua se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në bashkëpunim me fakultetet, organizon seanca informimi për studentët në lidhje me rëndësinë e rezultateve të vlerësimit të pedagogut të lëndës për përmirësimin e programit të studimit. Konkretisht, referuar evidencës 3.8 GVJ vlerësoi punën e bërë në lidhje me trajnimin e gjithë stafit akademik për përdorimin e sistemit TEAMS gjatë periudhës së pandemisë. Gjatë takimit në institucion, GVJ u informua se edhe në laboratorët e pajisura me teknologjinë e fundit ishte trajnuar i gjithë stafi akademik me qëllim përdorimin e frytshëm të paisjeve teknologjike.
<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve</b>	
	X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	
	X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”**


**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Kurrikula është në përputhje me objektivat dhe qëllimet e programit të studimit. Ajo ofron mundësi mobiliteti brenda dhe jashtë vendit duke ndihmuar në procesin e ndërkombëtarizimit. Partneritetet me institucionet brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë dhe bashkëpunimi më të mirë për një sërë aktivitetesh të përbashkëta ka rritur cilësinë dhe ka zhvilluar më tej dinamikën akademike të programit të studimit.
2. Praktika të mira, të ndërmarra nga institucioni në drejtim të përfshirjes së stafit akademik dhe studentëve në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.
3. Stafit akademik është i kualifikuar me tituj e grada shkencore, me eksperiencë të larmishme akademike, shkencore, shkëmbimi me partnerë të huaj, drejtuese. Kujdes i veçantë, rritja e vazhdueshme e burimeve njerëzore, evidentuar nga rekrutimi i stafit të brendshëm dhe të jashtëm sipas standardeve më të larta të sigurimit të cilësisë.
4. Logjika e ndjekur për shtrirjen e lëndëve sipas kategorive duke i përshtatur me shkallën e vështirësisë në mënyrë progressive dhe të natyrshme.
5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik krijojnë terrenin e volitshëm për arritjen e objektivave formuese të këtij programi studimi për transferim studimesh, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)





6. Mbështetje e plotë për studentët e programit Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim dhe klimë pozitive në komunikimin midis stafik akademik dhe studentëve.
7. Përfshirja e studentit në vlerësimet periodike të formave të mësimdhënies dhe të stafit akademik, si edhe përfaqësimi i tyre në organet më të larta të institucionit, rritin sigurinë e studentëve në përballimin me sukses të gjithë problematikës gjatë kohës së studimeve Bachelor.
8. Infrastruktura fizike e mirëpajisur me mjetet dhe pajisjet laboratorike moderne u jep mundësi pedagogëve të shfrytëzojnë teknologjitë e reja në funksion të mësimdhënies si dhe u krijojnë studentëve të këtij programi kushte të përshtatshme për mësimnxënien, kërkimet në bibliotekë etj.
9. Nxitja e shkëmbimeve për stafin akademik dhe studentët, përmes Erasmus +.
10. Veprimtari të shumta shkencore dhe ekstrakurrikulare në kuadër të bashkëpunimeve kombëtare dhe ndërkombëtare të personelit akademik dhe institucionit, shumë të vlefshme për avancimin në kërkimin shkencor për stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi.
11. Pavarësisht se nuk ofrohet asnjë praktikë profesionale për asnjërin profil të këtij programi studimi, janë për t'u vlerësuar qasjet e përdorura për studimin e tregut të punës.
12. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë monitoron cilësinë në programin e studimit, duke vepruar me të gjitha mekanizmat që disponon kjo strukturë dhe duke pasqyruar rezultate konkrete të arritjes së objektivave për programin e studimit.

#### **Pika të dobta**

1. Numri i studentëve është në rënie, por në përputhje me kuotat e ofruara për çdo vit akademik. **(Standardi V.4, Kriteri 1)**
2. Më shumë përparësi dhe mbështetje për botim të teksteve universitare. **(IV,4,kriteri 2)**
3. Numri i kufizuar i mobilitetit të studentëve drejt universiteteve të huaja dhe përfshirjes së tyre në projekte ndërkombëtare, mbetet një sfidë që po trajtohet me prioritet nga njësia bazë dhe strukturat përkatëse të institucionit dhe për këtë po draftohen marrëveshje të reja bashkëpunimi. **(Standardi I.5, kriteri 3)**
4. Sistemi e-student nuk ka funksionuar në mënyrë të qëndrueshme në vitet e fundit. **(Standardi V.4, kriteri 4)**

#### **Rekomandime**

1. Sistemi e-student të funksionojë sistematikisht dhe të krijohen arshiva elektronike.
2. Të krijohet një mundësi lehtësuese për akses në ambientet e fakultetit për studentët me aftësi ndryshe.







3. Hyrjet e reja në bibliotekë të jenë në numër më të madh për njësi duke mundësuar konsultim më të gjerë nga studentët e pedagogët.
4. Të sensibilizohen studentët për një përfshirje më të gjerë në plotësimin e pyetësorëve.

**Conclusions of the evaluation of the study program of the first cycle Bachelor in French language with the following profiles; language and communication, French language, literature and civilization, translation and interpretation of the Institution of Higher Education "University of Tirana".**

**Strengths and affirmations**

1. The curriculum is consistent with the objectives and goals of the study program. It offers opportunities of mobility by contributing to the internationalization process. Partnerships with the institutions inside and outside the Republic of Albania and their cooperation for a series of joint activities has increased the quality and further developed the academic dynamics of the study program.
2. Good practices undertaken by the institution in terms of the involvement of academic staff and students in national and international projects.
3. The academic staff is well qualified with scientific titles and grades along with diverse academic, scientific and managerial experiences and exchange experiences with foreign partners, as well. Special attention is paid to the continuous growth of human resources, evidenced by the recruitment of full-time and part-time staff according to the highest standards of quality assurance.
4. The logic followed for the extension of subjects according to categories adapting them to the degree of difficulty in a progressive and natural way.
5. The distribution according to training activities and the relationship between theoretical and practical training create a favorable ground for achieving the training objectives of this study program for study transfer, mobility and employment at the end of studies.
6. Full support for students of the Bachelor program in French language with the following profiles; language and communication, French language, literature and civilization, translation and interpretation and positive climate in communication between academic staff and students.
7. The student's involvement in the periodic evaluations of teaching methods and academic staff as well as their representation in the highest bodies of the institution increase the students' confidence in successfully dealing with all the problems during their Bachelor studies.



8. The well-equipped physical infrastructure with modern laboratory equipments gives lecturers the opportunity to use new technologies in the teaching function and creates for the students of this study program suitable conditions for learning, researching in the library, etc.
9. Promotion of exchanges for academic staff and students through Erasmus +.
10. Numerous scientific and extracurricular activities in the framework of national and international collaborations of the academic staff and institution, very valuable for the advancement of scientific research for the academic staff and students of this study program.
11. Despite the fact that no professional practice is offered for any profile of this study program, the approaches used for the study of the labor market are to be evaluated.
12. The Internal Quality Assurance Unit monitors the quality of the study program by acting with all the mechanisms available to this structure and reflecting concrete results of achieving the objectives for the study program.

### **Weaknesses**

1. The number of students is decreasing, but in accordance with the quotas offered for each academic year. **(Standardi V.4, Kriteri 1)**
2. More priority and support for publishing university texts. **(IV,4,kriteri 2)**
3. The limited number of students' mobility toward foreign universities and their involvement in international projects remains a challenge that is being treated as a priority by the basic unit and the relevant structures of the institution, and as such new cooperation agreements are being drafted. **(Standardi I.5, kriteri 3)**
4. The e-student system has not functioned stably in recent years. **(Standardi V.4, kriteri 4)**

### **Recommendations**

1. The e-student system should function systematically and electronic archives should be created.
2. Create a facilitating opportunity for access to the faculty premises for disabled students.
3. New entrances to the library should be in larger numbers per unit enabling wider consultation by students and lecturers.
4. Sensitize the students for a wider involvement in completing the questionnaires.

### **Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit**



Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

<b>I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				<b>X</b>
<b>IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				<b>X</b>
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE</b>				<b>X</b>
<b>VLERËSIMI PËRSONOR</b>				<b>X</b>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

